

Plan i realizueshëm financiar për qasje të njëjtë në programet  
e fëmijërisë së hershme në Republikën e Maqedonisë

# fer-lojë



CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.2(497.7)

RAVENS, Jan van

Fer-lojë / Jan van Ravens. - Shkup : Ministri i punës dhe politikës sociale, 2010 - 106 стр. : илустр. ; 29 цм

фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 97-100

ISBN 978-608-4595-13-7

а) Предучилишно воспитание и образование - Македонија

COBISS.MK-ID 85133834

Plan i realizueshëm financiar për qasje të njëjtë në programet  
e fëmijërisë së hershme në Republikën e Maqedonisë

# fer-lojë

Nga  
Jan Ravens, konsultant,  
[van.ravens@yale.edu](mailto:van.ravens@yale.edu)  
Shtator 2010



# Përmbajtja

Rezyme përmbledhëse.....	5
Falënderim.....	11
Shkurtesat .....	13
Hyrje .....	17
<b>1.</b> Cilat janë trendët e regjistrimit të fëmijëve në kopshtet formale për fëmijë .....	19
<b>2.</b> Grupi primar i moshës për ZHHF .....	27
<b>3.</b> Dallimet e regjistrimit në arsimin parashkollor.....	33
<b>4.</b> Qendrat për ZHHF.....	41
<b>5.</b> Parimet e politikës së zgjerimit të qasjes .....	49
<b>6.</b> Shpenzimet e sigurimit të qasjes universale për fëmijët e moshës 4 dhe 5-vjeçare .....	61
<b>7.</b> Qëndrueshmëria financiare .....	73
<b>8.</b> Rekomandimet .....	87
Literatura e shfrytëzuar.....	89



## Rezyme përmbledhëse

**N**ë vitin 2004, me Strategjinë Nacionale për Zhvillimin e Arsimit 2005-2015 dhe ndryshimet e plotësimet e Ligjit për Mbrojtjen e fëmijëve, u theksua nevoja urgjente për forma alternative në arsimin parashkollor, në të cilat do të përfshihen të gjithë fëmijët pa dallim të prejardhjes. Ky raport jep përgjigje në pyetjen “Si?”: si të përmbushen në vitin 2010 premtimet që ishin përcaktuar me ligj në vitin 2004?; Si t'i realizojmë në praktikë të drejtat e padiskutueshme ligjore të fëmijëve më pak të privilegjuar? Parakushtet për t'u përgjigjur në këto pyetje janë këto: (i) kufizimet financiare me të cilat ballafaqohet sot Maqedonia; (ii) lëvizja e madhe drejt vetëqeverisjes lokale; dhe (iii) angazhimi i pushtetit qendror për sigurimin e qasjes në shërbimet themelore për të gjithë fëmijët.

Duke iu referuar këtyre shërbimeve korrekte, në një artikull të botuar në “The Lancet” thuhet se fëmijët duhet të inkuadrohen në aktivitete grupore që nga mosha trevjeçare. Një burim tjetër autoritar rekomandon fillimin e aktiviteteve grupore për fëmijët qysh dy vjet para regjistrimit të tyre në shkollë fillore, përkatësisht në moshën katërvjeçare. Të dyja burimet pajtohen se që nga fillimi i parë e më tej, grupet e lëna anash të prindërve duhet të kenë mbështetje profesionale në edukimin e fëmijëve të tyre.

Mbështetja e tillë profesionale mund të arrihet përmes investimit në sistemin aktual. Ndonëse ai sistem është para së gjithash i orientuar drejt aspekteve shëndetësore, do të duhet nxitet stimulimi i hershëm, që të shkarkohen infermieret. Qendrat e zhvillimit të hershëm janë po ashtu të pozicionuara mirë që t'i mbështesin prindërit. Megjithëse mbështetja për prindërit është një rekomandim i fuqishëm, përsëri ky raport fokusohet në përfshirjen më të madhe ose në regjistrimin e vetë fëmijëve. Duke e pranuar gjendjen e vështirë ekonomike të ditëve tona në vend, hapi i parë i raportit do të jetë vetëm përfshirja e fëmijëve të moshës 4 dhe 5-vjeçare, ndërsa më pas, me përmirësimin gradual të gjendjes financiare, do të vijojë inkuadrimi edhe i fëmijëve të moshës 3-vjeçare.

Përfshirja e fëmijëve të moshës 4 dhe 5-vjeçare në KF-të formale është 23%. Shumica e këtyre fëmijëve janë nga familje të rajoneve urbane, ku të dy prindërit e tyre kanë të ardhura, madje thuaja të gjitha nënat e këtyre fëmijëve kanë të mbaruar shkollë të mesme ose të lartë. Megjithatë numri i fëmijëve shqiptarë dhe romë që janë të inkuadruar është i vogël. Hulumtimi për dobritë e ZHHF-ve tregojnë se me këto programe arrihen kthesa më të mëdha kur ato janë të orientuara drejt fëmijëve më të marginalizuar. Gjendja financiare në vend nuk mund ta shpjegojë shkallën e ulët të fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor; në krahasim me vendet e tjera të rajonit, madje edhe nëse merren parasysh të ardhurat për banor. Nëse merren parasysh shpenzimet e mëdha dhe fakti se kopshtet e fëmijëve para së gjithash u shërbejnë grupeve të pasura, është pak e mundur që kopshtet e fëmijëve të zgjerohen aq shpejt e aq shumë, që t'i përfshijnë edhe grupet më të varfra.

Në shumë vende ky problem është tejkaluar përmes hapjes së qendrave joformale për ZHHF ose të qendrave në vetëqeverisjen vendore. Maqedonia në vitin 2000 e përvetësoi këtë risi të rëndësishme dhe i themeloi 350 qendra për ZHHF në mjediset e marginalizuara, gjithë kjo me ndihmë financiare nga Banka Botërore dhe me mbështetje të UNICEF-it. Për fat të keq, shumica e këtyre qendrave janë mbyllur si pasojë e konfliktit të vitit 2001 dhe për shkak të mungesës së financimit strukturor. Por, evaluimi i bërë para do kohe, që ishte realizuar në 17 qendrat që ende funksionojnë – ku vijojnë mësim rreth 800 fëmijë – dëshmon se ato kanë potencial të madh për nxitjen e zhvillimit të fëmijëve dhe për mbështetjen e prindërve. Me zbatimin e Standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm ata do të mund të ofrojnë programe cilësore të përshtatura për nevojat dhe kushtet e familjeve në zonat ku gjenden, vetëm nëse sigurohet financim strukturor dhe nëse koha për realizimin e aktiviteteve rritet, për shembull, në 3 orë në ditë gjatë 5 ditëve të javës, me nga një orë kohë plotësuese për secilin sesion për arsimtarin.

Përvojat e vendeve të tjera dëshmojnë se këto programe gjysmëditore mund të jenë të qëndrueshme nëse nuk inkuadrohen në këtë sistem të arsimit parashkollor, por nëse integrohen në sistem të ri, me ndarje të re të kompetencave, ku kopshtet e fëmijëve po ashtu do ta gjejnë vendin e tyre. Kjo na shpie në një grup të parimeve të politikës që bazohet në përpjekjet për drejtësi sociale ose “fer-lojë” (lojë korrekte).

Parimi i parë është se zhvillimi i fëmijëve duhet përkufizohet si funksion primar në programeve për ZHHF. Në këtë aspekt duket se programet gjysmëditore janë po aq të mira – nëse jo edhe më të mira – sa programet tërëditore. Prandaj mund të themi se programet gjysmëditore për fëmijët e moshës 4 dhe 5-vjeçare – e më pas edhe për fëmijët e moshës 3-vjeçare – paraqesin shërbimin themelor publik që meriton financim publik. Funksioni sekondar i programeve për ZHHF është që t'i çlirojë prindërit që ata të mund të punojnë, të studiojnë ose të realizojnë aktivitete të tjera. Kjo rëndom kërkon program të kushtueshëm tërëditor me ushqime dhe fjetje. Në shumë vende ky funksion është çështje private. Nuk ka ndonjë argument me të cilin mbështetet subvencionimi i funksionit të ruajtjes së pjesës më të pasur e më të paktë të popullatës, nëse funksioni për zhvillimin e fëmijëve është plotësisht i pasigurt për shumicën më të varfër. Prandaj propozohen programe gjysmëditore të subvencionuara për të gjithë, të pasur e të varfër, – ndërsa për ata që dëshirojnë program tërëditor do të paguhet çmim korrekt për shërbimet plotësuese. Kopshtet e fëmijëve edhe më tej mund të sigurojnë programe të tilla tërëditore për të gjithë klientët, por ndryshimet do të ndodhin në mënyrat e financimit.

Parimi i dytë i politikës ka të bëjë me ofertën. Nëse ndodhë zgjerimi i menjëhershëm i programeve gjysmëditore në Maqedoni, kjo mund të jetë edhe e përealizueshme dhe e paqëlluar – që të themelohen shumë qendra të reja për ZHHF për një periudhë të shkurtër. Kopshtet aktuale të fëmijëve mund t'i zgjerojnë kapacitetet e tyre për programe gjysmëditore, por mund të paraqiten edhe ofrues të rinj të këtyre shërbimeve, siç janë kopshtet dhe kompanitë private për fëmijë, si dhe kapacitetet me kushte shtëpiake. Prandaj nevojitet një sistem më i rreptë i akreditimit. Institucionet që do ta fitojnë akreditimin do të kenë të drejtë të sigurojnë programe tërëditore për fëmijë të moshës katër dhe pesëvjeçare dhe do të përfitojnë për secilin fëmijë veçmas. Kështu krijohet “hapësirë për mundësi të barabarta”. Kopshtet aktuale për fëmijë mund të ndërmarrin rol plotësues të qendrave të resurseve.

Parimi i tretë është financimi i qëndrueshëm. Kontributi që e japin donatorët e huaj dhe sponsorët privatë duhet të përdoret vetëm që të mbuloen shpenzimet fillestare, siç janë renovimi, inventari, zhvillimi i programeve dhe trajnimi fillestar. Shpenzimet operative duhet t'i bartë dhe t'i mbulojë qeveria dhe qytetarët, ndërsa kjo nënkupton mirëmbajtjen e objekteve, ripërtëritjen e rregullt të inventarit dhe investimin e vazhdueshëm në programe të resurseve humane.

Parimi i katërt dhe i fundit është këmbimi i drejtë i barrës së shpenzimeve operative. Vlerësoget se këto shpenzime arrijnë deri në 387 milionë denarë në vit. Kjo bazohet në *njësinë e shpenzimit* për program gjysmëditor që kushton rreth 9.700 denarë për fëmijë në vit, të shumëzuar me 35.000 fëmijë të moshës 4 dhe 5-vjeçare që nuk kanë qasje në kopsht. Kjo është rritje për 14.7% për mbulimin e shpenzimeve plotësuese në rajonet me denduri të vogël të popullsisë. Për sigurimin e 387 milionë denarëve ekzistojnë katër burime:

1. Prindërit mund të paguajnë kompensim prej 400 denarë në muaj për program gjysmëditor. Por, që të shmanget përjashtimi i më të varfërve, së paku familjet që janë shfrytëzues të ndihmës sociale në para duhet të jenë të liruar nga pagesa e kompensimit. Në atë rast të ardhurat do të ishin 142 milionë denarë në vit. Nëse grupi më i madh i popullatës që jeton në kufirin e varfërisë lirohet nga pagesa e këtij kompensimi, kjo shumë do të zvogëlohej në 67 milionë denarë. Mundësia e tretë është që këto programe gjysmëditore, më herët a më vonë, të jenë falas. Në atë rast kuptohet se të ardhurat do të jenë zero.
2. Në kopshtet aktuale ekzistojnë mjaft hapësirë për kursim nga efikasiteti i punës së tyre, në kushte kur çmimi aktual i kostos për fëmijë në vit është thuajse sa gjysma e të ardhurave mesatare të një qytetari të Maqedonisë. Në vende të tjera të rajonit njësia shpenzim është më e vogël për një të pestën e të ardhurave mesatare vjetore. Përgjysmimi i dallimit me këto vende të tjera liron 310 milionë denarë në vit; më pak se qëllimi i synuar për kursimin e 155 milionë denarëve.
3. Një pjesë e resurseve për programe gjysmëditore mund të sigurohen përmes rritjes modeste të kompensimit që paguhet për programe tërëditore në kopshtet e fëmijëve. Ky kompensim është 1.500 denarë, por shpenzimet reale janë katër herë më të mëdha. Familjet që kanë fëmijë në programe tërëditore fitojnë dhjetë herë më shumë subvencionim nga shteti se familjet që kanë fëmijë në programe gjysmëditore dhe paguajnë kompensim. Rritja e kompensimit për programin tërëditor në 2.000 denarë shpie drejt shumës 106 milionë denarë; ndërsa, nëse rritet në 2.500 denarë, kështu fitohen 211 milionë denarë. Në rastin e dytë familjet që i përdorin kopshtet e fëmijëve përsëri do të fitojnë tetë herë më shumë subvencionim shtetëror se ato që i përdorin programet gjysmëditore.
4. Pjesëmarrja me 387 milionë denarë që duhet t'i sigurojë Qeveria varet nga ajo se sa do të fitohet nga tre burimet e sipërpërmendura. Për secilin prej këtyre burimeve ka nga dy ose tre variante, prej të cilave burojnë gjithsej 12 mundësi ose skenarë për financim. Siç duket, se në shumicën e këtyre skenarëve barra e Qeverisë është e barabartë me zero ose është thuajse negative. Vetëm nëse nuk paguhet kompen-

sim për programet gjysmëditore; nëse kopshtet e fëmijëve realizojnë përfitim minimal nga efikasiteti i tyre dhe nëse kompensimi që paguhet për kopshtet e fëmijëve mezi rritet, ngarkesat e mbetura për Qeverinë do të jetë 100 milionë denarë. Ose, më saktë: 126 milionë denarë.

Rritja e kësaj shume të parave pengohet nga rritja e vlerësuar e tre buxheteve referente (arsim, shëndetësi dhe politikë sociale), madje edhe me shumë parashikime të kujdesshme për rritjen e ekonomike. Përveç kësaj, zhvillimi demografik – në veçanti zvogëlimi i numrit të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme – paraqet një mundësi unike për zgjerimin e shërbimeve për ZHHF-të në 5 vitet e ardhshme.

Ndarja e shpenzimeve në esencë paraqet çështje politike për të cilën nuk mund të japim përgjigje me këtë raport. Ajo patjetër duhet bazohet në bisedime ndërmjet të gjithë aktorëve në Maqedoni. Ne shpresojmë se raporti do ta lehtësojë dialogun.

Po ashtu propozohet që implementimi i politikës së propozuar në vitin 2011 të fillojë në dhjetë komuna: në pesë komuna ku qendrat për ZHHF janë funksionale dhe në pesë komuna të reja që do të zgjidhen në bazë të përgatitjes dhe nevojave që i kanë. Do të ishte mirë nëse në disa prej këtyre komunave ka kopshte të fëmijëve që do ta kishin marrë rolin e qendrave të resurseve.



# Falënderim

Ky raport ishte porositur nga zyra nacionale e UNICEF-it në Shkup. Autori shpreh falënderimin e tij të singertë para së gjithash për dr. Nadica Janevën nga Enti i Nënave dhe Fëmijëve, Shtëpia e Shëndetit – Shkup, që paraqet fuqi lëvizëse të Rrjetit të ZHHF-ve në Maqedoni, si dhe për dr. Nora Shabanin, specialiste për zhvillimin e arsimit në zyrën UNICEF-it në Shkup. Ky raport nuk do të ishte ky që është pa ndihmën e tyre të jashtëzakonshme.

Me këtë rast në veçanti vlerësohen informacionet tejet të rëndësishme, të mbledhura nga këta njerëz:

- Në Komunën e Konçes: Ljupka Jovanova, edukatore në Qendrën për ZHHF në Komunën e Konçes; Blazho Jovanov, inspektor komunal dhe Lençe Kërsteva, asistent i financave.
- Në Komunën e Radovishit: Daniela Kacareva dhe Ljupka Trençevska, edukatore në qendrën për ZHHF në komunitetin rom Shein Maale dhe Vioeta Efundieva, udhëheqëse e sektorit të financave në Komunë.
- Në Komunën e Manastirit: drejtori i shkollës, Ilija Kërbaleski, nga qendra për ZHHF në Dolno Orizari dhe kryetari i Komunës së Novacit, L Lazar Kotevski.

Prindërit me të cilët u takuam në qendrat për ZHHF në Manastir dhe Radovish ishin ekspertë në mënyrën e tyre. Ata ndihmuan që t'i kuptojnë nevojat dhe ëndrrat e njerëzve për të cilët u hartua ky raport.

Jan Van Ravens, Holandë  
Fakulteti i Edvard Zingelrit, Qendra për Zhvillim të Fëmijëve dhe Politikë Sociale  
Universiteti Jejl, SHBA



# Shkurtesat

AGJ	Arsimim për të Gjithë
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
GKZHKHF	Grupi Konsultativ për Zhvillim dhe Kujdes të Hershëm për Fëmijët
EQL/KSHP	Evropa Qendrore dhe Lindore dhe Komonuelti i Shteteve të Pavarura
HMIK	Hulumtimi Multiindikator për Klasterë
KF	Kopshti i Fëmijëve
NSP	Ndihma Sociale në Para
OJQ	Organizata Joqeveritare
OZHBE	Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik
PKS	Përgjegjësia Korporative Sociale
SHBFR	Shkalla Bruto e Fëmijëve të Regjistruar
SHNFR	Shkalla Neto e Fëmijëve të Regjistruar
SNZHVA	Strategjia Nacionale për Zhvillimin e Arsimit
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
UNESKO	Organizata për Arsim dhe Shkencë e Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
ZHHF	Zhvillimi i Hershëm i Fëmijëve
ZHHFA	Zhvillimi i Hershëm i Fëmijëve dhe Arsimit



## Lista e tabelave

Nr.	Titulli	Faqja
1	Fëmijë të regjistruar në KF formale në Maqedoni sipas moshës, 2000-2007	10
2	Numri dhe shkalla e fëmijëve të regjistruar në KF formale sipas moshës, 2007	13
3	Numri i fëmijëve të regjistruar dhe numri i orëve për fëmijë të kaluara në 17 qendra për ZHHF, 2010	28
4	Dallimi në njësinë shpenzim për program gjysmëditor dhe tërëditor në rajonin e EQL/ Komonueltit të Shteteve të Pavarura (2007/2008)	34
5	Llogaritja e mesatares së matur nacionale për shpenzimet plotësuese për dendësinë e popullatës	46
6	Shpërndarja e 100 fëmijëve sipas ndihmës sociale në para dhe kriterit të varfërisë	50
7	Shpërndarja e 100 fëmijëve sipas KF-ve dhe sipas kriterit të varfërisë	50
8	Llogaritja e të ardhurave vjetore nga kompensimi i përdoruesve, sipas variablës së ulët, të mesme dhe të lartë	51
9	Llogaritja e dobisë nga efikasiteti i KF-ve dhe sipas variablës së lartë dhe të ulët	51
10	Llogaritja e dobisë që buron nga rritja e kompensimit që paguhet në KF sipas variablës së lartë dhe të ulët	52
11	Skenari për ndarjen e shpenzimeve	52
12	Investimet kapitale për arsim në Maqedoni, 2010, 2011, pastaj	58

## Lista e skicave

Nr.	Titulli	Faqja
1	Numri i përgjithshëm i fëmijëve të regjistruar në KF-të formale në Maqedoni, 2000-2007	10
2	Numri i fëmijëve të regjistruar në KF-të formale në Maqedoni sipas moshës, 2000-2007	11
3	Shkalla e fëmijëve të regjistruar në KF-të formale sipas moshës, 2007	14
4	Dy modelet alternative për strukturimin e ZHHF-ve në Maqedoni	16
5	Formularë të regjistrimit të fëmijëve të moshës së caktuar në vende të caktuara, 2004	17
6	Numri i fëmijëve të moshës 3, 4 dhe 5-vjeçare të regjistruar në arsimin parashkollor sipas përkatësisë etnike (2005)	19
7	Numri i fëmijëve të moshës 3, 4 dhe 5-vjeçare të regjistruar në arsimin parashkollor sipas të ardhurave (2005)	20
8	Numri i fëmijëve të moshës 3, 4 dhe 5-vjeçare të regjistruar në arsimin parashkollor sipas vendbanimit dhe arsimimit të nënës (2005)	20
9	Shkalla neto e fëmijëve të regjistruar të moshës 3, 4 dhe 5-vjeçare përballë BPV-së për banor, 2008	23
10	Krahasimi i njësive shpenzim për program tërëditor si përqindje e BPV-së për banor në pesë vende.	32
11	Blok-subvencionet për fëmijë të regjistruar (e kuqe) dhe për secilin fëmijë që jeton në komunë (e kaltër), 2008	33
12	Numri i fëmijëve të lindur në Maqedoni (1998-2008)	41
13	Dendësia e popullsisë në Maqedoni sipas rajoneve, 2009	46
14	Shfrytëzuesit e ndihmës sociale të moshës 18-vjeçare dhe më të moshuar, 2008	49
15	Buxhetet e mbrojtjes sociale, arsimit dhe shëndetësisë, 2003-2010	54
16	Popullata e Maqedonisë sipas gjinisë dhe sipas grupmoshës gjatë pesë viteve, 30 qershor 2009	56

# Hyrje

**N**ë Strategjinë Nacionale për Zhvillimin e Arsimit 2005-2015 (SNZHA), Republika e Maqedonisë (2004) mori një vendim të qartë dhe tejet të rëndësishëm për politikën në fushën e Zhvillimit të Hershëm të Fëmijëve (ZHHF). Maqedonia i përcaktua për rritje të ndjeshme të përfshirjes së fëmijëve në nivelin parashkollor ose, ashtu si njihen më mirë, në kopshtet e fëmijëve, ose në programet alternative dhe inovative. Me këtë rast në veçanti u theksuan fëmijët e grupeve dhe rajoneve të margjinalizuara. Kjo ishte vendosur në vitin 2004 me amendament në Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve (neni 20), me të cilin ishte vënë theks i veçantë në nevojat e fëmijëve të zonave të larta dhe të rrezikuara në aspekt demografik.

Me një angazhim të këtylligjor dhe politik, u bë patjetërsueshme nevoja për paraqitje të serishme të korpusit të dëshmvive për ndikimin e programeve formale dhe alternative për ZHVHF ndaj fëmijës, familjes, shoqërisë dhe ekonomisë. Tashmë nuk ka nevojë që askush të bindet se Maqedonia e ka tejkaluar stadiumin e lobimit për ZHHF. Ne vend të kësaj ky raport tash fokusohet në pyetjen “Si?”: si të përmblushen në vitin 2010 premtimet që ishin përcaktuar me ligj në vitin 2004?; Si t'i shndërrojmë në praktikë të drejtat ligjore të fëmijëve më pak të privilegjuar?

Në përpjekje për të dhënë përgjigje, ky raport e paraqet dhe e studion mundësinë financiare për sigurimin e qasjes universale në (së paku) programet gjysmëditore për ZHHF për (përsëri së paku për) fëmijët e moshës 4 dhe 5-vjeçare. Argumentet për këto dy zgjidhje – së pari fokusi i programeve gjysmëditore dhe i fëmijëve të moshës 4-5 vjeçare – do të studiohen në këtë raport; do të diskutohet se ajo paraqet një kompromis të arsyeshëm ndërmjet asaj që është e nevojshme nga perspektiva e zhvillimit të

fëmijës dhe asaj që është e mundur në kontekst të kufizimeve momentale financiare në Maqedoni.

Përveç kësaj, ky raport është harmonizuar edhe me ndodhitë vijuese në fushën e udhëheqjes dhe financimit në Maqedoni, përfshirë edhe parimet e përcaktuara me marrëveshjen për decentralizimin fiskal (Martinez-Vasquez, Timofeev, Feruglio, 2007) dhe instrumentet e ofruara për hartimin e këtyre principeve (Cyan, Martinez-Vazquez and Timofeev, 2009). Raporti presupozon se konteksti në të cilin do të zhvillohet zgjerimi i përfshirjes me programet për ZHHF në vitet e ardhshme nga njëra anë do të përcaktohet nga lëvizja e madhe drejt vetëqeverisjes lokale, ndërsa nga ana tjetër do të përcaktohet nga përgjegjësia e pushtetit qendror për sigurimin e qasjes në shërbimet themelore për fëmijët dhe familjet.

Katër kapitujt e parë paraqesin analizë të gjendjes momentale. Në kapitullin e parë studiohet përfshirja e fëmijëve në kopshtet formale të fëmijëve, si një formë dominuese në ZHHF në Maqedoni. Pastaj konfirmohet se me këtë program rëndom sigurohen shërbime për fëmijët e grupeve të privileguara. Në kapitullin e dytë shtrohet pyetja për atë se cila grupmoshë duhet të ketë përparësi duke i pasur parasysh resurset e mangëta; krahasimi në nivel ndërkombëtar e mbështet këtë analizë. Në kapitullin e tretë diskutohet dallimi në qasjen në shërbimet për ZHHF përballë zvogëlimit të standardit jetësor për fëmijët. Po ashtu në këtë kapitull përsëri zbatohen përcaktimet për krahasimin me nivelet ndërkombëtare. Kapitulli i katërt i referohet përvojës nga puna e ZHHF-ve, që ishin themeluar në vitin 2000: çka mund të mësohet nga ato që ende funksionojnë mirë dhe cilat janë shkaqet e dështimit të qëndrueshmërisë së qendrave të tjera?

Kapitulli i pestë paraqet pjesën më të rëndësishme të këtij raporti. Në bazë të katër kapitujve të tjerë dhe, duke u qëndruar besnik ideve për udhëheqje dhe financim në Maqedoni, formulohen edhe parimet themelore të politikës me të cilat mund të realizohet zgjerimi i programeve për ZHHF në një të ardhme të afërt. Kapitujt vijues paraqesin përpunim të atyre parimeve. Në kapitullin e gjashtë bëhet një vlerësim i shpenzimeve të nevojshme për sigurimin e qasjes universale për fëmijët e moshës 4 dhe 5-vjeçare, ndërsa kapitulli i shtatë paraqet pasqyrë të qëndrueshmërisë financiare të kësaj politike në plan afatgjatë.

Përfundimisht, kapitulli i tetë jep rekomandime. Rekomandimi themelor është që të fillohet me zbatimin politikës së propozuar në 10 komuna në vitin 2011: në pesë prej atyre komunave ka qendra për ZHHF funksionale, ndërsa pesë të tjerat do të zgjidhen në bazë të përgatitjes dhe nevojave që i kanë.

## Cilat janë trendët e regjistrimit të fëmijëve në kopshtet formale për fëmijë

Në hulumtimin tonë për mënyrën e cila do të bëhet universale për qasje në programet e zhvillimit të hershëm të fëmijëve në Maqedoni së pari filluam me analizën e trendëve të regjistrimit të fëmijëve në institucionet më reprezentative: pra kopshtet zyrtare për fëmijë, të cilat tashmë disa dekada janë institucionet e vetme për ZHHF. Sa herë që në këtë raport flitet për kopshtet formale për fëmijë, të cilat dallohen nga institucionet alternativa të deritanishme, siç janë qendrat për ZHHF, ky term i referohet institucionit që ka shkurtesën KF. Maqedonia disponon me të dhëna të shkëlqyeshme për regjistrimin e fëmijëve në KF edhe sipas moshës. Tabela 1 përmban rezyme të këtyre të dhënave për periudhën 2000-2007. Së pari duhet të themi se ne fokusohemi në numrat *absolutë* për numrin e fëmijëve të regjistruar në KF; ndërsa më tej në këtë kapitull ato të dhëna ndërliiden me të dhënat për popullatën, që ashtu të fitohet *shkalla* e fëmijëve të regjistruar.

**Tabela 1:** Numri i fëmijëve të regjistruar në KF në Maqedoni, 2000-2007


	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Më të vegjël se 3 v.	673	754	620	805	491	764	927	1491
3 vjet	3091	3346	3239	3472	3280	3423	3684	4440
4 vjet	3603	3624	3787	3771	3949	3854	4254	4822
5 vjet	7189	6510	6996	6698	7421	8419	8038	5948
6 vjet	18857	17563	17078	17031	16797	17931	19695	906
7 vjet & më të rritur	1807	2202	1992	2119	1784	697	1397	74
Gjithsej	35220	33999	33712	33896	33722	35088	37995	17607

**Burimi:** Të dhënat janë siguruar në Maqedoni për bazën e të dhënave TransMONEE <http://www.unicef-irc.org/databases/transmonee/>

**Shënim:** Të dhënat u referohen kopshteve, institucioneve përgatitore të arsimit parashkollor ose fillor. Këtu nuk janë përfshirë fëmijët e moshës 0-2 vjeç të vendosur në çerdhe, të cilat janë në kompetencë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale.

Së pari studiohet numri i përgjithshëm i fëmijëve të regjistruar në KF. Në Skicën 1 është paraqitur zhvillimi gjatë viteve të fundit. Shënimet vijnë nën skicën.

**Skica 1:** Numri i përgjithshëm i fëmijëve të regjistruar në KF-të formale në Maqedoni, 2000-2007




**Burimi:** Të dhënat janë siguruar në Maqedoni për bazën e të dhënave TransMONEE <http://www.unicef-irc.org/databases/transmonee/>

Është shumë e qartë se fakti që numri i përgjithshëm i fëmijëve të regjistruar ndërmjet viteve 2006 dhe 2007 është përgjysmuar, ndërsa kjo shpjegohet me ndryshimin e moshës në të cilën regjistrohen fëmijët në shkollë fillore, nga moshja shtatë në atë gjashtëvjeçare. Por, edhe përkundër kësaj ndërhyrje konkrete në politika, numri i përgjithshëm i fëmijëve të regjistruar nuk ka ndryshuar shumë në periudhën ndërmjet viteve 2000 dhe 2006. Ky numër edhe më tej ka shënuar rënie deri në vitin 2002; ka mbetur shumë i ulët deri në vitin 2004, e pastaj shënohet një ngritje e vogël ndërmjet viteve 2004 dhe 2006. Me fjalë të tjera, Skica 1 ashtu siç është flet për shkaqet e shpresës se numri i fëmijëve të regjistruar në KF-të formale do të rritet vetvetiu. Kapacitetet e përgjithshme janë aq shumë të kufizuara, ashtu që qysh më parë duket se mjetet financiare të pushtetit (në nivel nacional dhe lokal) dhe të prindërve janë të pamjaftueshme që të pritet ndonjë rritje e madhe e numrit të fëmijëve të regjistruar në këtë tip të programit të shtrenjtë për ZHHF (informacionet për njësitë e shpenzimit në KF, si dhe për qendrat alternative për ZHHF vijnë në kapitullin 5 të këtij raporti).

Megjithatë në Skicën 1 nuk është paraqitur numri i fëmijëve të regjistruar sipas moshës së tyre. Ka mundësi që për grupmosha të caktuara skica të jetë ndryshe. Ashtu si në Skicën 1, edhe Skica 2 është krijuar nga të dhënat e tabelës 1, por paraqitja e saj i përmbledh katër grupmoshat e ndryshme: fëmijë të moshës nën 3 vjeç, fëmijë të moshës 3-vjeçare, fëmijë të moshës 4-vjeçare dhe fëmijë të moshës 5-vjeçare. Arsyeya pse në

këtë skicë nuk janë përfshirë fëmijët e moshës 6-7-vjeçare shpjegohet me ndryshimin e moshës së regjistrimit të tyre në shkollë fillore që nga viti 2007. Për shkak të kësaj mase të politikës, fëmijët e moshës 6-7-vjeçare praktikisht nuk gjenden më në KF-të formale, ashtu siç shihet edhe në tabelën 1. Komentet në lidhje me Skicën 2 vijnë nën të.

**Skica 2:** Fëmijë të regjistruar sipas moshës në KF-të formale në Maqedoni, 2000-2007



**Burimi:** Të dhënat janë siguruar në Maqedoni për bazën e të dhënave TransMONEE <http://www.unicef-irc.org/databases/transmonee/>

Informacioni më i ndryshueshëm i Skicës 2 është numri i fëmijëve të regjistruar në moshën 5-vjeçare. Kolona ngjyrë vjollce lëviz lart-poshtë, që flet për faktin se familjet që kanë fëmijë të moshës 5-vjeçare në këtë periudhë konkrete janë ballafaquar me rrethana të ndryshueshme. Rënia e numrit të fëmijëve të regjistruar të moshës 5-vjeçare ndërmjet viteve 2006 dhe 2007 mund të ndërlidhet me zvogëlimin e moshës për regjistrim në shkollë fillore; disa familje vendosin që fëmijët e tyre 5-vjeçarë t'i regjistrojnë në shkollë fillore në vend që t'i regjistrojnë në KF-të formale, fjala bie, për shkak se kushton më lirë. Kjo dukuri haset edhe në shumë vende të tjera.

Regjistrimi i fëmijëve të moshës 3 dhe 4-vjeçare (kolonat e kuqe dhe të gjelbra) është zakonisht stabil, vetëm me një rritje të vogël në vitet 2006 dhe 2007. Kjo flet se ekziston se (i) ekziston një “grup i caktuar shoqëror” në Maqedoni, të cilin si duket e përbëjnë familjet që kanë të ardhura të larta ose të dyfishta, që kanë edhe kanë nevojë t'i regjistrojnë fëmijët e tyre në KF-të formale dhe (ii) ka hapësirë shumë të kufizuar për rritje më të madhe në grup të privilegjuar. Përveç këtij grupi në të cilin “qasja është stabile”, ekziston edhe grupi i marginalizuar që kërkon t'i regjistrojë vetëm fëmijët e moshës 5-vjeçare. Ky grup i marginalizuar është paraqitur në mënyrë simbolike me një pjesë të kolonës ngjyrë vjollce që ngrihet mbi kolonat e kuqe dhe të gjelbra. Nga Skica

2 mund të shihet se madhësia e këtij grupi dallohet dukshëm gjatë viteve dhe është zvogëluar në vetëm 1.000 fëmijë në vitin 2007.

Në fund ekziston edhe një grup i familjeve, numri i të cilave po rritet me shpejtësi, të cilat mund t'ia lejojnë vetvetes t'i regjistrojnë fëmijët që nga moshën 0-3-vjeçare. Kolona e kaltër flet për një rritje të vazhdueshme në periudhën ndërmjet viteve 2004 dhe 2007. Ky grup ndoshta është i vogël në krahasim me grupmoshat e tjera, por shumica e përgjithshme e të hollave që nevojiten është dukshëm më e madhe, sepse kujdesi për fëmijët më të vegjël është shumë më intensiv në aspekt të mundit që duhet të jepet.

Nëse e shikojmë pasqyrën e madhe që na paraqitet në Skicën 2, vërehet një prirje drejt një "zvogëlimi të caktuar". Për shembull, në vitin 2004 numri i fëmijëve të moshës 5-vjeçare në KF formale ishte rreth 7.500, që ishte thuajta dy herë më shumë se numri i fëmijëve të moshës 3 dhe 4-vjeçare, ndërsa numri i fëmijëve të moshës nën 3 vjeç ishte i pakonsiderueshëm. Deri në vitin 2007 numri i fëmijëve të moshës 5-vjeçare mezi arrinte të jetë më i madh se i fëmijëve të moshës 3 dhe 4-vjeçare, ndërsa numri i fëmijëve të moshës nën 3 vjeç ngadalë u ngrit deri në atë nivel. Ose, me fjalë të tjera, qasja në KF-të formale ka ardhur në një grup të njëjtë, që paraqet grup që vazhdimisht kërkon praninë për 17.500 vende në KF-të formale. Të gjithë fëmijët e tjerë janë lënë jashtë, jo vetëm për një ose dy vite, por gjatë gjithë fëmijërisë së tyre.

Madhësia e saktë e atij grupi të fëmijëve të përjashtuar nga kjo mundësi nuk mund të përcaktohet nga numrat absolutë të fëmijëve të regjistruar. Kjo imponon nevojën që të merren në konsideratë të dhënat për gjithë popullatën dhe të llogaritet shkalla e regjistrimit. Në Tabelën 2 për secilën grupmoshë janë dhënë këto të dhëna: (i) numri përgjithshëm i fëmijëve në Maqedoni; (ii) shkalla absolute e regjistrimit të fëmijëve të asaj grupmoshe që janë të regjistruar; dhe (iii) shkalla e regjistrimit për moshë konkrete, ndërsa ky është numri i fëmijëve të regjistruar sipas moshës i ndarë me numrin e përgjithshëm të fëmijëve, gjithë kjo shprehur në përqindje. Në Tabelën 2 është përmbledhur ndarja e fëmijëve të moshës 0-7 sipas vitit konkret, përfshirë edhe moshën 0-3-vjeçare. Për arsye që do të shpjegohen më poshtë, në këtë tabelë janë përfshirë edhe disa *grupime*: 0-7, 0-6, 0-5, 3-5 dhe 4-5 dhe për secilin grupim të këtillë është dhënë shkalla e regjistrimit.

**Tabela 2:** Regjistrimi i fëmijëve sipas moshës dhe shkallës së regjistrimit në KF-të formale, , 2007

Grupmoshat	Numri i përgjithshëm i fëmijëve			Të regjistruar në KF	Shkalla e regjistrimit (në %)
	Djem	Vajza	Bashkërisht		
0	11479	10836	22315	541	2.4
1	11248	10868	22116	1337	6.0
2	11984	11042	23026	1005	4.4
3	11958	11284	23242	4440	19.1
4	11840	11068	22908	4822	21.0
5	12516	11773	24289	5948	24.5
6	13182	12353	25535	906	3.5
7	12480	11625	24105	74	0.3
Gjithsej 0-7			187536	17681	9.4
Gjithsej 0-6			163431	17607	10.8
Gjithsej 0-5			137896	16701	12.1
Gjithsej 3-5			70439	15210	21.6
Gjithsej 4-5			47197	10770	22.8

**Burimi:** Të dhënat janë siguruar në Maqedoni për bazën e të dhënave TransMONEE <http://www.unicef-irc.org/databases/transmonee/>


Përmes paraqitjes së të dhënave për fëmijët e regjistruar sipas moshës, bëhet e qartë se në kohën tonë regjistrimi është përqendruar kryesisht ndërmjet fëmijëve të moshës 3, 4 dhe 5-vjeçare, me shkallë konkrete të regjistrimit prej 19.1%, 21.0% dhe 24.5% në pajtim me ato grupmosha. Kjo është paraqitur në Skicën 3 (më poshtë). Ashtu siç tërhoqëm vëmendjen për numrat absolutë të tabelës, shkalla e regjistrimit të fëmijëve të moshës 6 dhe 7-vjeçare është zvogëluar ndjeshëm pasi që është zvogëluar mosha e pranimit të tyre në shkollë fillore, ndërsa shkallët e regjistrimit të fëmijëve të moshës 0, 1 dhe 2-vjeçare janë edhe më vogla edhe përkundër rritjes së paradokohshme; bashkë me fëmijët e moshës 0-2-vjeçare nëpër çerdhe ky numër arrin në 4.334 në vitin 2007 dhe 4.515 në vitin 2008, duke rezultuar me shkallë prej 8%.

Në Tabelën 2 më e rëndësishme është llogaritja e shkallës së përgjithshme të regjistrimit. Në rastin e ZHFH-ve kjo paraqet çështje të ndërlikuar që duhet të përpunohet në këtë raport. Në parim, shkallët e fëmijëve të regjistruar në arsim llogariten ashtu që numri

i fëmijëve të regjistruar merret si numërues, ndërsa numri i përgjithshëm i fëmijëve në grupin relevant të moshës si emërues. Në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë është relativisht e qartë se cili është grupi relevant i moshës, sepse kjo është përcaktuar me ligj. Në raport me ZHHF-të mund të thuhet se të gjithë fëmijët e moshës 0-7-vjeçare kanë të drejtë të ndjekin KF formale dhe prandaj kjo është përfshirja e moshës për të cilën duhet të jemi të kujdesshëm. Ashtu siç është paraqitur në Tabelën 2, përcaktimi i tillë do të rezultonte me shkallë të përgjithshme të fëmijëve të regjistruar që arrin në 9.4%.

Megjithëse fëmijët 7-vjeçarë duhet të jenë në shkollë fillore, e jo në KF, numri i tyre është shumë i kufizuar. Por, numri absolut i fëmijëve 7-vjeçarë është shumë më i madh, përfaqëson sa numri fëmijëve të cilësdo grupmoshë. Kështu, nëse nuk merren në konsideratë fëmijët 7-vjeçarë, numëruesi zvogëlohet vetëm pak, ndërsa emëruesi zvogëlohet mjaft. Që këtu, shkalla e përgjithshme e fëmijëve të regjistruar të moshës 0-6-vjeçare është 10.8%, që është pak më e lartë se 9.4% për grupmoshën. Po ashtu shkalla rritet edhe më tej në 12.1% nëse nuk i marrim në konsideratë fëmijët 6-vjeçarë.

**Shkica 3:** Shkalla e fëmijëve të regjistruar në KF formale sipas moshës, 2007



**Burimi:** Të dhënat janë siguruar në Maqedoni për bazën e të dhënave TransMONEE <http://www.unicef-irc.org/databases/transmonee/> Shih shënimin nën Tabelën

Idetë e këtilla kanë të bëjnë edhe me fëmijët më të vegjël. Numri i fëmijëve të regjistruar të moshës 0-3 është shumë i vogël dhe, nëse këta fëmijë nuk merren në konsideratë në shkallën e përgjithshme të fëmijëve të regjistruar – përkatësisht përmes përfshirjes së fëmijëve të moshës 3-5-vjeçare – shkalla kërcen në 21.6%. Në fund, fokusimi i fëmijëve të moshës 4-5-vjeçare rezulton me shkallë 22.8%. Në Skicën 3 shihet se regjistrimi i

fëmijëve të grupmoshës themelore 3-5 (ose 4-5) vjeçare vërtet lëviz nga 20% deri në 25%. Ndonëse kjo nënkupton se jo më pak se 75% deri në 80% e të gjithë fëmijëve në Maqedoni janë lënë jashtë, numri 20%-25% jep diçka që është një fotografi më adekuate dhe më pak e mjegulluar sesa numri prej rreth 12% që shpeshherë përmendet në politika.

Njëri nga përfundimet e këtij kapitulli është se llogaritja e shkallës momentale të fëmijëve të regjistruar nuk paraqet vetëm çështje teknike. Rezultati i llogaritjes së tillë më shumë varet nga ajo se në cilën moshë konkrete fokusohemi (0-5? 3-5? 4-5?). Në esencë ajo është çështje e politikës, mundësisht e vendosur në dëshmi shkencore dhe krahasime në nivel ndërkombëtar. Kjo është temë e kapitullit vijues.



## Grupi primar i moshës për ZHHF

**C**ilado strategji e zgjerimit me programe për ZHHF duhet ta përkufizojë nivelin real të ambicieve në raport me moshat që duhet të përfshihen. Pastaj, regjistrimi i të gjithë fëmijëve që nga lindja e deri në fillimin e shkollimit fillor nuk është i pakapërcyeshëm, madje edhe sikur të arrihen programe që kushtojnë më pak se KF-të formale. Pasqyra e dhënë në Skicën 3 të kapitullit të kaluar e dëshmon këtë: arritja 100% e të gjitha kolonave të kaltra është sfidë dekurajuese, ndërsa nëse kufizohemi vetëm në dy ose tre kolona që tashmë e kanë tejkaluar 20%-shin, gjithçka bëhet më reale.

Përveç kësaj nuk ka nevojë të regjistrohen të gjithë fëmijët e moshës 0-6-vjeçare dhe kjo mund të jetë e padëshirueshme në aspekt të zhvillimit të fëmijëve. Ekspertët e ZHHF-së – shih raportin e Hulumtimit Multiindikator për Klasterë (MICS), të realizuar në Maqedoni në vitet 2005-2006 (Enti i Statistikës i Republikës së Maqedonisë, 2007:45) – kanë arritur konsensus të gjerë:

- Fëmijët rriten më mirë në mjedis shtëpiak gjatë tre ose katër viteve të para të jetës së tyre, *me kusht që të përmbushën rrethana të caktuara në atë mjedis*:
  - prindërit duhet të disponojnë me disa shkathtësi prindërore;
  - paqetë duhet të jenë të pranishme lodrat dhe mënyrat e tjera të stimulimit;
  - paqetë duhet të ekzistojë mjedis i shëndoshë; etj.
- Arsimitimi i prindërve mund të ndihmojë që këto kushte të përmbushen, veçmas te grupet dhe rajonet e marginalizuara (Evans, 2006)

- Fëmijët duhet të marrin pjesë në aktivitetet grupore – lojëra, mësim, këndim, para mësimit të shkrim-leximit në moshë 3 dhe 4 vjeçare e përpjetë gjithnjë derisa nuk fillojnë të shkojnë në shkollë fillore.

Megjithatë ekzistojnë dallime të caktuara në të menduarit në lidhje me atë se kur është mosha e saktë kur duhet të inkuadrohen ato përvoja grupore për fëmijët. Në këtë aspekt dy nga idetë me ndikim më të madh dallohen pak më shumë. Nga njëra anë është Grupi Konsultativ për Zhvillim dhe Kujdes të Hershëm të Fëmijëve (Consultative Group on Early Childhood Care and Development – CGECCD, 2008), ku zënë vend aktorët kryesorë të ZHHF-ve, përfshirë edhe UNICEF-in dhe Bankën Botërore. Politika e tyre e quajtur “Katër themelet” propozon që fëmijët të inkuadrohen në aktivitete grupore gjatë dy viteve para regjistrimit të tyre në shkollë fillore në moshës 6-vjeçare – kjo do të thoshte se fëmijët duhet të regjistrohen në KF ose në qendrat alternative për ZHHF në moshë 4 ose 5-vjeçare. Kësaj do t’i paraprinte *mbështetja e prindërve*, që nga lindja, madje edhe më herët. Ajo mund të jetë formë grupore e edukimit për prindërit, mbështetje individuale për prindërit, për shembull, përmes vizitave në shtëpitë e tyre ose edhe kombinim i këtyre dy formave.

Nga ana tjetër ekziston edhe një seri e tre shkrimeve në revistën shkencore mjekësore “The lancet”, të botuara në vitin 2007. Në njërin prej këtyre artikujve Engle et al (2007:238) propozojnë që të bëhen *ndërrhyrje qysh në fëmijërinë e hershme përmes familjeve dhe kujdestarëve, ndërsa aktivitetet grupore për mësim duhet të shtohen në moshën prej 3 deri në 6 vjeç, veçanërisht për grupet marginalizuara*. Ose, me falë të tjera, Engle et al këshillojnë që të fillohet me pjesëmarrje në grup një vit me herët se ajo që e propozon CGECCD-ja.

Engle et al po ashtu rekomandojnë të përdoren shërbimet aktuale (2007:238) për zgjerimin e ZHHF-ve. Në kontekst të gjendjes në Maqedoni, i a.q. sistem i shërbimeve të patronazhit duket si platformë e mirë prej të cilës më tej mund të zhvillohet mbështetja e mëtejme për prindërit. Shërbimi i patronazhit tashmë ka përfshirë 78% familje (Janeva, 2008)<sup>1</sup>. Por, sistemi i patronazhit është kryesisht i medikalizuar dhe ky sistem duhet të fuqizohet përmes integritit të elementeve kognitive dhe socio-psikologjike, si dhe përmes stimulimit të hershëm dhe mësimit (Janeva, 2008, udhëzohet në pasqyrën përmbledhëse të literaturës nga Regalado, 2001). Përvojat e vendeve të tjera dëshmojnë se zgjerimi i tillë është i mundur, veçmas kur do të ndërlihet mbështetja për prindërit dhe lloji i qendrave për ZHHF që janë përshkruar në kapitullin 4 të këtij raporti

1 Janeva (2008) zbulon se veçmas e lartë, 98%, është përqindja e fëmijëve të Maqedonisë që janë të përfshirë në kontrollimet preventive shëndetësore dhe këshillimet për prindërit gjatë vitit të parë të jetës.

(van Ravens, 2010a dhe 2010b). Sistemi i patronazhit duhet të fuqizohet me zvogëlimin e përfshirjes së popullatës nga 6.600 (në Shkup është më e lartë dhe shkon deri në 8.660) të normave nga 5.000 për popullatën urbane dhe 3000-4000 për popullatën rurale. Alternativë janë qendrat për ZHHF. Sidoqoftë, raporti i përmendur për MICS (Enti i Statistikës së Republikën e Maqedonisë, 2005:92-93) dëshmon se shkalla e kontributit të mjedisit shtëpiak për zhvillimin dhe mësimin e fëmijëve në veçanti dallohet në raport me pasurinë e familjes, me nivelin arsimor të prindërve dhe përkatësinë etnike (pastaj grupet e pakicave shqiptare dhe rome mbeten prapa në raport me të tjerat)

Në Skicën 4 në një kornizë është paraqitur modeli që propozohet nga artikujt në “The Lancet” dhe modeli që propozohet nga CGECCD-ja, por i përkthyer në kontekst të Maqedonisë. .

**Skica 4:** Dy modele alternative për strukturimin e ZHHF-ve në Maqedoni


Mosha	Sipas modelit të propozuar në “The Lancet”	Sipas modelit të propozuar nga CGECCD
Prenatale		
0		
1	Mbështetje për prindërit	Mbështetje për prindërit
2		
3		
4	KF ose qendër për ZHHF	KF ose qendër për ZHHF
5		

Tashmë është e qartë se zgjedhja ndërmjet këtyre dy modeleve është shumë e rëndësishme dhe për atë nevojitet debat politik rrënjësor. Modeli i propozuar në “Lancet” mund të ketë më shumë ndikim në zhvillimin e fëmijës, sepse ai nënkupton se regjistrimi në aktivitetet grupore fillon një vit më herët. Por, modeli Lancet është po ashtu më i shtrenjtë në raport me njësinë shpenzim për një vit në grup sesa një vit mbështetje për prindërit, siç dëshmojnë përvojat e vendeve të tjera (van Ravens, 2008a, 2008b, 2009, 2010b).

Me qëllim që të zhvillohet debat informativ në lidhje me dy modelet, Skica 5 i paraqet disa “profile të vendeve” në raport me fëmijët e regjistruar në programet për ZHHF sipas moshës. Këto profile janë kopjuar nga botimi i vitit 2007 i Raportit të Monitorimit Global “Arsim për të gjithë”, i cili fokusohet në ZHHF-të. Fatkeqësisht të dhënat për këto vende janë të vitit 2004 dhe që andej që të bëhet krahasim, duhet të përdoren të dhënat e vitit 2004 për Maqedoninë (kur mosha e fillimit të shkollimit fillor ishte 7 vjeç). Por, ajo që është e rëndësishme është shqyrtimi i gjendjes në Maqedoni nga perspektiva ndërkombëtare.

Diskutimi përsëri vijon pas skicës; për ta kuptuar më mirë është e rëndësishme të dihet se kolonat me ngjyrë kafe të errët paraqesin sasinë e përfshirjes në programe parashkollore, ndërsa kolonat me ngjyra kafe të çelur paraqesin përfshirjen e fëmijëve në shkollat fillore. Nën këndin horizontal gjendet moshja (3-7); ndërsa numrat e errët paraqesin moshën kur fillon shkolla fillore në secilin vend.

**Skica 5:** Trendi i regjistrimit të fëmijëve sipas moshës në vende të caktuara, 2004



**Burimi:** Kopje nga UNESCO, 2006:140-141

Në Skicën 5 është paraqitur se në më shumë se tetë shtete regjistrimi i fëmijëve në programe parashkollore fillon në moshën 3-vjeçare. Në Francë regjistrimi në programet parashkollore të fëmijëve të moshës 3-vjeçare është universal, por kjo paraqet përjashtim të vërtetë. Bashkë me Italinë dhe Belgjikën, edhe Franca është ndër vendet me programe të tjera të subvencionuara për qasje, që janë të hapura edhe për fëmijë të vegjël. Në Slloveni, në SHBA dhe në Finlandë shihet se regjistrimi i fëmijëve në programe parashkollore në moshën 3, madje edhe 4 e 5-vjeçare nuk është diçka universale. Në këto vende vërehet rritje graduale bashkë me rritjen e moshës, ndërsa regjistrimi i fëmijëve bëhet diçka universale në moshën 6-vjeçare, pavarësisht a bëhet fjalë për arsim parashkollor ose fillor. Megjithatë duhet të theksohet se për shumë fëmijë të këtyre vendeve që nuk janë regjistruar në programe parashkollore është siguruar përkujdesje në kapacitetet private ose kapacitetet që janë vënë në dispozicion nga punëdhënësit. Kjo po ashtu haset edhe në Zvicër dhe në Holandë, ku regjistrimi i fëmijëve të moshës 3-vjeçare në programe është i vogël dhe thuaja mungon fare, ndërsa regjistrimi i fëmijëve 3-vjeçarë në programet private është shumë i lartë.

Në vendin më të varfër të paraqitur në Skicën 5, në Kirgizi, ka numër më të paktë të fëmijëve të regjistruar, por vërehet se regjistrimi i fëmijëve të moshës 3-vjeçare nuk është më i vogël se regjistrimi i fëmijëve të moshës 4 dhe 5-vjeçare. Kjo është si pasojë e faktit se një elitë e vogël i shfrytëzon të gjitha resurset e programit për ZHHF si një formë e lirë e përkujdesjes ditore të fëmijëve (van Ravens, 2010c), ndërsa familjet e shtresave të larta ose të mesme në shumë vende paguajnë për ato shërbime në institucionet private. Siç duket, gjendja në Maqedoni dallohet vetëm pak – jo esencialisht – nga gjendja në Kirgizi. Duke i pasur parasysh krahasimet në nivel ndërkombëtar, duket se është krejt e padrejtë që të gjitha resurset publike të shkojnë në shfrytëzim të një grupi të vogël të fëmijëve që kanë më pak nevojë për një shërbim të tillë nga perspektiva e zhvillimit fëmijëror. Më shumë informacione për mbështetjen e këtyre pohimeve janë dhënë në kapitullin e pestë të këtij raporti.

Për më shumë informacione në lidhje me trendët e regjistrimi të fëmijëve në programet parashkollore në vendet e tjera, përdoreni këtë lidhje <http://www.unesco.org/education/GMR/2007/chapter6.pdf> dhe faqet 140 dhe 141, ku janë paraqitur profilet e 60 vendeve.

Përfundimi nga krahasimi i bërë në nivel ndërkombëtar është se sigurimi programeve publike për ZHHF të moshës 3-vjeçare nuk është ndonjë përjashtim. Megjithatë, në situata të rralla kjo është diçka universale, ndërsa në Zvicër dhe Holandë – por edhe në shumë vende, si Austria e Koreja – shihet se tregu është ai që e përcakton a do të regjistrohen fëmijët e moshës 3-vjeçare. Argumenti themelor është se regjistrimi i fëmijëve të moshës 3-vjeçare nuk është i patjetërsueshëm në aspekt të zhvillimit të fëmijës dhe, po qe se prindërit dëshirojnë t'i regjistrojnë fëmijët e tyre në këtë moshë, kjo është për shkaqe praktike – sepse punojnë – e jo për shkaqe arsimore.

Që këtu, zgjedhja ndërmjet modelit Lancet (regjistrimi i fëmijëve në moshën 3-vjeçare e më lart) dhe modelit GCECCD (regjistrimi i fëmijëve të moshës 4-vjeçare e më lart) është burim politik që arsyetohet me debat politik, por ky raport hëpërhë do të bazohet në modelin GECCD. Modeli CGECCD është më i lirë se modeli Lancet dhe në të ardhmen çdoherë mund të ndryshohet me modelin tjetër.


Nëse i kthehemi Tabelës 2 dhe Skicës 3, mund të përfundojmë se sfidë për vitet e ardhshme do të jetë shkalla e regjistrimit të fëmijëve të moshës 4-vjeçare që nga 21.0% të ngrihet në 100%, ndërsa shkalla e regjistrimit të fëmijëve të moshës 5-vjeçare nga 24.5% të rritet deri në 100%. Në numra absolutë kjo do të thotë se numri i fëmijëve të regjistruar duhet të rritet për rreth 9.000 fëmijë të moshës 4 dhe 5-vjeçare në përafërsisht 47.000 fëmijë. Ose, më konkretisht, vlerësimet precize për numrin e fëmijëve që duhet të regjistrohen në të ardhmen vijon në kapitullin e gjashtë të këtij raporti.



## Dallimet e regjistrimit në arsimin parashkollor

**N**a kapitullin paraparak erdhëm në përfundim se Maqedonia është para një rrugë të gjatë derisa të arrijë që të gjithë fëmijët e moshës 4 dhe 5-vjeçare të regjistrohen në ndonjë formë në arsimin parashkollor. Tashmë dihet se 75% deri në 80% të fëmijëve nuk janë përfshirë në këtë nivel të arsimit dhe në këtë kapitull analizohet shkalla deri në të cilën ky përjashtim buron nga karakteristikat e caktuara që kanë të bëjnë me prejardhjen, siç janë përkatësia etnike, pasuria, vendbanimi (rural ose urban) dhe niveli arsimor i prindërve.

**Skica 6:** Fëmijët e regjistruar në arsimin parashkollor të moshës 3, 4 dhe 5-vjeçare, sipas përkatësisë etnike (2005)




Burimi: Enti i Statistikës i Republikës së Maqedonisë/UNICEF, 2007

Skica 6 flet se fëmijët e përkatësisë etnike maqedonase kanë më shumë mundësi të regjistrohen në këtë arsim për dallim prej fëmijëve shqiptarë dhe romë (shkalla më e lartë është e fëmijëve të regjistruar që u takojnë “grupeve të tjera”, por kjo kategori është shumë më pak e rëndësishme në raport me numrat absolutë). Për fat të keq, dallimi i tillë etnik është larg asaj që merret si normale, por në Maqedoni kjo është shumë e shprehur se, fjala bie, në Serbi dhe Kirigizi (Qendra Hulumtuese UNICEF Inocenti, 2009:108).

(Skica 6 nuk ka të bëjë vetëm me fëmijët e moshës 4 dhe 5 vjeçare, por edhe me fëmijët e moshës 3-vjeçare, sepse ato janë grupet e rritura që janë paraqitur në raportin për MICS-2005, i cili është burim të të dhënave për këtë paraqitje).

Dallime të ngjashme ekzistojnë edhe te fëmijët që u takojnë grupeve të ndryshme në bazë të të ardhurave. Në Skicën 7 familjet janë ndarë në 5 grupe me madhësi të njëjtë sipas të ardhurave (20% secila prej tyre) dhe janë paraqitur shkallët e fëmijëve të regjistruar në kuadër të secilës prej atyre tre grupeve. Edhe kjo u referohet fëmijëve të moshës 3, 4 dhe 5-vjeçare.

**Skica 7:** Fëmijët e regjistruar në arsimin parashkollor në moshë 3, 4 dhe 5-vjeçare sipas të ardhurave (2005)




**Burimi:** Enti i Statistikës i Republikës së Maqedonisë/UNICEF, 2007

Nuk është për t’u befasuar që numri i fëmijëve të regjistruar rritet me rritjen e të ardhurave, ndonëse dallimi ndërmjet kuintalëve të katërt dhe të pestë është i vogël. Ose, me fjalë të tjera, qasja rëndom është privilegj i 40% të grupeve më të pasura. Meqë mundësitë

për zhvillim të fëmijëve zakonisht lidhen me gjendjen socio-ekonomike, Skica 7 ofron dëshmi se programet për ZHFH në Maqedoni nuk arrijnë të ata fëmijë që kanë më shumë nevojë për to.

Për fund: Skica 8 e paraqet dallimin ndërmjet fëmijëve të zonave rurale dhe urbane dhe dallimin ndërmjet fëmijëve që i kanë nënat pa kurrfarë arsimimi, fëmijëve që i kanë nënat vetëm me arsim fillor dhe fëmijëve që kanë nëna me arsim të mesëm ose të lartë.

**Skica 8:** Fëmijët e regjistruar në arsimin parashkollor të moshës 3, 4 dhe 5-vjeçare sipas lokacionit dhe nivelit arsimor të nënave të tyre.



**Burimi:** Enti i Statistikës i Republikës së Maqedonisë/UNICEF, 2007

Dhe, të përsërisim: nuk është e pazakonshme që fëmijët e zonave urbane të kenë qasje më të mirë në shërbimet për ZHFH në krahasim me fëmijët e zonave rurale, por ky dallim në Maqedoni është vërtet i pazakonshëm. Kjo ka të bëjë edhe me dallimin që ekziston ndërmjet fëmijëve që kanë nëna pa kurrfarë arsimi ose me arsim fillor dhe fëmijëve që kanë nëna me arsim të mesëm ose të lartë. Kjo meriton një vëmendje të veçantë.

Karakteristikat që kanë të bëjnë me prejardhjen, siç janë përkatësia etnike, të ardhurat dhe vendbanimi (rural/urban) mund të merren si “tregues” për nevojat e fëmijëve. Prej shumë dëshmimeve shkencore tashmë është e njohur se është normale që janë të diskriminuar në mënyra të ndryshme fëmijët që vijnë nga përkatësi etnike të pakicave kombëtare, nga grupet që kanë të ardhura më të vogla dhe të rajoneve rurale, në krahasim me fëmijët që nuk u takojnë këtyre grupeve. Në kundërshtim me këtë, niveli

arsimor i nënës është më shumë se vetëm tregues; kjo në mënyrë të drejtpërdrejtë flet për nevojën e mbështetjes së familjes në edukimin e fëmijës. Nënata që nuk kanë ndonjë arsimim të mjaftueshëm, për shembull, nuk kanë qasje në njohuri të caktuara me shkrim për praktikatat e mira në ruajtjen e fëmijëve, e as që mund t'u lexojnë përralla fëmijëve të tyre. Nga hulumtimet e bëra për të arriturat në arsim, siç janë PISA dhe TIMSS, bëhet e qartë se arsimi i nënës paraqet treguesin më të suksesshëm për suksesin e fëmijës në arsim.

Që këtu, në esencë Skica 8 tregon se 20 deri në 25% të fëmijëve në Maqedoni të moshës 4-5 vjeçare që në këtë moment janë të regjistruar në programet për ZHHF nuk kanë ndonjë nevojë të veçantë për një shërbim të tillë, kjo në aspekt të zhvillimit fëmijëror. Mjedisi i tyre shtëpiak në përgjithësi atyre u ofron kushte për zhvillim të mirë dhe ata kryesisht janë të regjistruar në këto programe, sepse në atë mënyrë prindërit e tyre mund të punojnë. Prandaj edhe një herë parashtrohet pyetja rreth arsytimit të shpenzimit të thuaja të gjitha resurseve që ndahen për programet për ZHHF për këtë grup të privilegjuar. Ashtu siç theksohet në dokumentin për qëndrimet në lidhje me ZHHF-në të Zyrës Rajonale të UNICEF-it për EQL/Komonueltin e Shteteve të Pavarura (2007:II.3) – duke i referuar me këtë rast Konventës së të Drejtave të Fëmijëve – duhet të fillohet me më të prekurit, përmes *zvogëlimit të pabarazisë sociale që ashtu të ndërpritet përcjellja e varfërisë nga gjenerata në gjeneratë*. Për këtë strategji po ashtu ekzistojnë edhe argumente ekonomike. Shumë dokumente për dobietë nga ZHHF-të i citojnë evaluimet e programeve amerikane, që thonë se paratë e investuara në ZHHF rezultojnë me dobi sociale që janë katër deri në shtatë herë më të mëdha se investimi fillestar, madje edhe më shumë. Por, me këtë rast patjetër duhet të kihet parasysh se këto programe amerikane janë të fokusuara fuqimisht në grupet e margjinalizuara. Sa më të margjinalizuara që janë grupet, aq më të mëdha janë dobietë për ta. Nga ana tjetër, mezi mund të pritët kthesë ekonomike nga investimi në ZHHF për grupet e privileguara. Thjesht nuk ekziston arsytim për investimin e tillë, sepse nuk ka ose ka fare pak vlerë plotësuese në edukimin e këtyre fëmijëve në institucione përballë edukimit të tyre në atmosferë familjare.

Ndërkohë ekzistojnë tregues për rritjen e numrit të fëmijëve në Maqedoni që janë të ekspozuar në rrezik. Përqindja e fëmijëve që mbeten prapa në rritjen e tyre ka shënuar rritje nga 8% në 12% në periudhën 1999-2000 dhe 2004-2006, kjo sipas Qendrës Hulumtuese UNICEF Inoçenti (2009 20). Sipas po këtij burimi, vdekshmëria të fëmijët e moshës nën 5 vjeç është zvogëluar thuaj në të gjitha vendet e rajonit të EQL/Komonueltit të Shteteve të Pavarura<sup>2</sup> në periudhën ndërmjet viteve 2000 dhe 2007,

2 EQL/Komonuelti i Shteteve të Pavarura nënkupton Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Komonuelitin e Shteteve të Pavarura (ish-Bashkimin Sovjetik).


por në Maqedoni – dhe në Ukrainë – vdekshmëria te këta fëmijë është rritur (Qendra Hulumtuese UNICEF Inoçenti, 2009: 19). Të dhënat nacionale të Entit Shtetëror të Statistikës dhe të Entit të Mbrojtjes Shëndetësore të Nënave dhe Fëmijëve shfaqin shpërndarje, por jo zvogëlim, por vdekshmëria prej 13.3% në 1000 fëmijë të lindur (në vitin 2009) tregon se ky fenomen te fëmijët e moshës nën 5-vjeçare është tre herë më i madh se niveli në BE (4 në vitin 2007).

Ka mundësi të pohohet se ndërprerja ose rënia e treguesve për shëndetin e fëmijëve më shumë i detyrohet rënies së përgjithshme të standardit jetësor sesa mungesës së shërbimeve konkrete për fëmijët e vegjël. Megjithatë, kjo hipotezë nuk mund të dëshmohet për shkak të një numri të caktuar të qasjeve empirike. Shkalla e vdekshmërisë së moshës 15-10 vjeç në Maqedoni është më e vogla në rajonin e EQL/Komonuellit të Shteteve të Pavarura dhe është më e ulët edhe se në Finlandë, Spanjë dhe në Mbretërinë e Bashkuar (Qendra Hulumtuese UNICEF Inoçenti, 2009: 23), ndërsa shkalla e vetëvrasjeve për këtë moshë – e cila mund të shihet si treguese e cilësisë së perceptuar për jetën në vend – është shumë më e ulët se në tre vendet e lartpërmendura plus Gjermaninë dhe është njëra ndër shkallët më të ulëta në rajonin e EQL/Komonuellit të Shteteve të Pavarura (Qendra Hulumtuese UNICEF Inoçenti, 2009: 24). Po ashtu bie në sy edhe numri i vogël i fëmijëve në Maqedoni që jetojnë në institucione (Qendra Hulumtuese UNICEF Inoçenti, 2009:32), në familje për përkujdesje ose që kanë tutorë (Qendra Hulumtuese UNICEF Inoçenti, 2009:34).

Megjithatë shumë më e pavoritshme – dhe e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me kushte e fëmijëve – është funksionimi i mbrojtjes sociale në Maqedoni. Në grupin e 12 vendeve të EQL/Komonuellit të Shteteve të Pavarura, në Maqedoni numri i fëmijëve, familjet e të cilëve kanë marrë shtesa fëmijërore në vitet 2005-2006, është më i vogël. Kjo përqindje ka qenë vetëm 9% dhe ka rënë në 13% në vitin 2000 (Qendra Hulumtuese UNICEF Inoçenti, 2009:79) (mesatarja e matur për 12 vende është rreth 58%).

Thënë ndryshe, ndërprerja ose rënia e treguesve për shëndetin e fëmijëve duket se është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me shërbimet e dobëta që sigurohen për fëmijët (nivelet e ulëta të mbështetjes financiare dhe përfshirja e vogël e fëmijëve në arsimin parashkollor) në vend të një rënieje të përgjithshme të standardit jetësor. Skica 9 e mbështet këtë hipotezë. Në të është paraqitur numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor në raport me BPV-në për banor (për vitin 2008 në dollarë amerikanë) për 23 vende të rajonit të përmendur të EQL/Komonuellit të Shteteve të Pavarura. Pika e kuqe e paraqesin Maqedoninë, ndërsa pikat e gjelbra, të verdha dhe të zeza i paraqesin vendet që do të analizohen më poshtë.

**Skica 9:** Fëmijët e regjistruar në arsimin parashkollor në moshë 3, 4 dhe 5-vjeçare në raport me BPV-në për banor, 2008



**Burimi:** Baza e të dhënave Transmonee

**Shënim:** katër vende mungojnë për shkak të mungesës së të dhënave: Sllovakia, Gjeorgjia, Turkmenistani dhe Uzbekistani. Slovenia, meqë dallohet shumë për nga të ardhurat e larta për banor në raport me vendet e tjera, po ashtu mungon nga ky raport.

Ashtu siç mund të pritej, linja e regresionit shkon përpjetë. Ose, me fjalë të tjera, sa më i pasur që është vendi, aq më i lartë është numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor. Që këtu, në shikim të parë duket se kjo e mbështet argumentin se niveli i ulët i të ardhurave për banor në Maqedoni shërben si “arsyetim” për shkallën e ulët të fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor. Megjithatë Skica 9 na mundëson ta vlerësojmë se në çfarë pozicioni është secili prej këtyre vendeve në raport me trendët e përgjithshëm. Në skicë mund të shihet se Maqedonia – e shënuar me ngjyrë të kuqe – është në vizën e regresionit. Kjo do të thotë se performansat janë më të këqija se të shumë vendeve të tjera, *madje* edhe kur kihet parasysh niveli i ulët i të ardhurave. Në Moldavi dhe Ukrainë – të dyja të shënuara me pika të gjelbra në këndin e majtë lart – kanë nivel më të ulët të të ardhurave në Maqedoni, por numër më të lartë të fëmijëve

të regjistruar në arsimin parashkollor. Kirgizia dhe Taxhikistani – dy pikat e verdha në këndin e majtë poshtë – kanë realizime më të dobëta se Maqedonia, por janë vende jashtëzakonisht të varfra. Vetëm Azerbajxhani dhe Bosnja e Hercegovina – të dyja të shënuara me pika të zeza nën Maqedoninë – vërtet kanë realizime më të dobëta se Maqedonia, duke e pasur parasysh nivelin e të ardhurave, por madje është shkallë më të ulët të fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor.

Me këtë rast mund të thuhet se në Skicën 9 gjenden dy grupe të ndryshme të vendeve: shtatë vende relativisht të pasura në këndin e sipërm djathtas – Republika Çeke, Hungaria, Polonia, vendet baltike, Kroacia – përballë vendeve të anës së majtë, ku të ardhurat për banor janë 3.000 dollarë ose më pak. Në ato raste projektimi i vizës së këtyllë të regresionit mund të na shpijë në përfundim të gabuar. Megjithatë, nëse vëmendjen tonë e orientojmë vetëm në grupin e dytë të vendeve, përfundimi për Maqedoninë do të ishte edhe më i qartë: Maqedonia në fakt është ndër vendet më të pasura në kuadër të grupit më të vogël, por shkalla e fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor është ndër më të ulëtat.

Duke e kuptuar nevojën urgjente për zgjerimin e programeve për ZHHF në Maqedoni dhe pastaj duke e parë se vendet e tjera të rajonit dëshmojnë se ky zgjerim është i realizueshëm, tash mund të orientohemi në elaborimin për qendrat për ZHHF në Maqedoni, të cilat ishin themeluar para rreth dhjetë viteve në përpjekje që të tejkalohen dallimet që u përshkruan më sipër.



## Qendrat për ZHHF

Përveç sistemit formal të arsimit parashkollor në kopshtet e fëmijëve, që ishte analizuar në kapitujt paraprak, në Maqedoni po ashtu ekziston edhe sistemi i qendrave alternative për zhvillim të hershëm të fëmijëve. Edhe pse për to mund të themi se janë qendra joformale, në esencë ato nuk janë ende pjesë e sistemit shtetëror. Një term tjetër që përdoret shpeshherë në literaturën për ZHHF-të është po ashtu edhe “qendra për ZHHF të bazuara në bashkësi”. Megjithatë për të dy termat ekzistojnë mospajtime të caktuara. Qendrat e reja për ZHHF nuk duhet të mbeten gjithnjë jashtë sistemit shtetëror, ndërsa a duhet të mbështeten plotësisht nga bashkësia është po ashtu çështje për debat të mëtejme. Nga kjo arsye, në këtë kapitull dhe më tej në këtë raport do të shërbehemi me një term neutral “qendra për ZHHF” ose, thjesht, *qendra*.

Ndonëse duket se qendrat për ZHHF janë më pak të rëndësishme se KF-të formale në raport me numrin e përgjithshëm të fëmijëve të regjistruar – sot ato i vizitojnë rreth 800 fëmijë, përballë 17.500 fëmijëve që shkojnë në KF, megjithatë ato paraqesin faktor kritik në inovacionin e arkitekturës së ZHHF-ve në Maqedoni. Si në shumë vende të tjera, këto qendra kanë për qëllim të sigurojnë shërbime për grupet e tjera për dallim nga shërbimet që i ofrojnë institucionet më formale dhe prandaj ato kanë karakteristika të ndryshme, ofrojnë shërbime të ndryshme dhe zakonisht punojnë në mënyrë më të dobishme. Për shembull, në Kirgizi ZHHF-ja formale shënon zhvillim të shpejtë, me çka nxit ndryshime në gjithë sistemin e arsimit parashkollor (van Ravens, 2010c). Përvojat e Kirgizisë dëshmojnë se institucionet më të vjetra dhe ato të reja nuk janë në armiqësi mes vete, por paraqesin pjesë përbërëse të një sistemi të ri më të balancuar në të cilin këto dy tipa të institucioneve janë të patjetërsueshme.

Nëse synohet që me sistemin e ZHHF-ve në Maqedoni të përfshihen të gjithë fëmijët në vend, kjo së paku pjesërisht do të duhet të arrihet përmes programeve të reja inovative dhe përfutuese. Kjo sigurisht nuk nënkupton se qendrat aktuale për ZHHF do të duhet të kopjohen, sepse ato nuk janë të përkryera, por pa dyshim mund të merren mësim të dobishme nga përvojat e funksionimi të këtyre qendrave.

Ky edhe është qëllimi i këtij kapitulli. Duke e pasur parasysh këshillën që strukturat aktuale të mbindërtohen sa më shumë që është e mundur (Engle et al, 2007), ky kapitull përmban përshkrim të qendrave për ZHHF në Maqedoni në raport me vizitueshmërinë dhe shërbimet që i ofrojnë ato. Më tej në raport është vendosur edhe analiza përkatëse financiare. Përveç nëse nuk shënuar ndryshe, informacionet që janë dhënë në këtë kapitull burojnë nga raporti i paradokohshëm për vlerësimin e bërë nga Nadica Janeva dhe ekipi i saj (Janeva, 2010); nga evaluimi strategjik për gjendjen e ZHHF-ve në Maqedoni (Janeva, 2010); nga informacionet që janë siguruar nga zyra e UNICEF-it në Shkup, si dhe nga vizitat në terren që janë bërë gjatë muajit korrik të vitit 2010.

## Qëllimet dhe funksionet e qendrave për ZHHF

Themelimi i qendrave për ZHHF në Maqedoni ka filluar në vitin 2000, atëherë kur Banka Botërore miratoi një grant që u mundësoi bashkësive lokale të fillojnë të hapin qendra të tyre për mbështetjen e UNICEF-it. Që nga fillimi, qëllimi i tyre ishte që në të të përfshihen fëmijët më të margjinalizuar, sepse ekzistonte një brengë e madhe në lidhje me shkallën e ulët të fëmijëve të regjistruar në KF-të formale dhe në raport me gjendjen e tyre zhvillimore dhe shëndetësore. Në atë kohë Maqedonia ishte e ndarë në 33 komuna – ndërsa sot territori është i ndarë në 85 komuna – dhe ndonëse në secilën prej kishte nga një KF, dendësia e shpërndarjes së tyre ishte aq e vogël, sa që jo vetëm që shumë fëmijë të mjediseve rurale ishin të penguar të shkojnë në kopshte të fëmijëve, por edhe prindërit nuk kishin mundësi ta paguajnë kompensimin.

Në 23 komuna (nga gjithsej 33) ishin themeluar gjithsej 350 qendra për ZHHF në gjithsej 196 bashkësi vendore, fshatra ose lagje. Të dhënat për numrin e fëmijëve të regjistruar në vitet e para mungojnë, por nëse në shumicën e qendrave do të regjistroheshin nga rreth 45 deri në 50 fëmijë – siç është gjendja edhe në qendrat e tjera sot – kjo do të thotë se numri i përgjithshëm i fëmijëve të regjistruar në qendrat për ZHHF patjetër do të sillej deri në 10.000 ose më shumë fëmijë. Ky është numër mjaft i madh në krahasim me 17.500 fëmijët që sot shkojnë në KF. Inkurajues është fakti që në Maqedoni ka mundësi të krijohen kapacitete për t'u bërë një hap i madh drejt përfshirjes së përgjithshme

të fëmijëve për vetëm disa vite. Në aspekt të financimit, si dhe në aspekt të vetë udhëheqjes, kjo ishte një iniciativë e rëndësishme që krijon bazë të mirë për shpresë dhe të pritura se ajo mund të bëhet përsëri.

Më pak inkurajues është fakti se shumica e qendrave nuk mund të mirëmbahen vetë. Shumica nga 350 qendrat janë mbyllur dhe duket se kjo është shkaktuar nga kombinimi i dy faktorëve. Së pari, konflikti i vitit 2001 dhe pasojat e tij paraqesin pengesë për vazhdimësinë e funksionimit të këtyre qendrave. E dyta, kjo iniciativë nuk mund të mbahej më tej, sepse mbështetja financiare dhe logjistike e agjencive ndërkombëtare gradualisht po zvogëlohej: rrëfim klasik për shumë projekte zhvillimore. Që këtu është e qartë se qëndrueshmëria e cilësdo iniciativë patjetër duhet të garantohet me aranzhmane të qëndrueshme financiare. Shpenzimet fillestare patjetër (pjesërisht) duhet të mbulohen me kontribute të përkohshme, por shpenzimet operative detyrimisht duhet të burojnë vetëm nga kontribute strukturore (p.sh.: nga pushteti qendror ose lokal dhe nga kompensimi që e paguajnë konsumatorët). Ky parim do të përpunohet veçmas në kapitullin 7.

Duke e pasur parasysh mësimin nxënë, tash do të fokusohemi në qendrat si të tilla. Ashtu siç ishte theksuar, qendrat para së gjithash kanë për qëllim t'i përfshijnë fëmijët e bashkësive më të marginalizuara dhe të varfra, ku fëmijët jo vetëm që kanë qasje të kufizuar në KF formale, por njësoj brengosëse janë edhe kushtet familjare ku rriten ata fëmijë. Prandaj repertori i aktiviteteve të qendrës është shumë më përfshirës se repertori i KF-së formale. Lista vijuese e pesë funksioneve themelore të qendrave bazohet në raportin e paradokohshëm të përgatitu nga Janeva (2010:1):

- Mbështetja për bashkësinë lokale në identifikimin e grupeve të fëmijëve të prekur;
- Organizimi i aktiviteteve të fokusuara në sigurimin e mbështetjes së fëmijëve të vegjël dhe të *prindërve të tyre* (italics JvR) në bashkësi (bashkëpunim intensiv me prindërit);
- Ndhimë dhe mbështetje për prindërit për qasje më të mirë në shërbimet themelore sociale për fëmijët e tyre të vegjël;
- Zbatimi i standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm (SMZHH) që ashtu të fuqizohet stimulimi i hershëm i zhvillimit të fëmijës për përgatitje më të mirë të tyre për arsim formal dhe për jetë.
- Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e ZHHF-ve në bashkësinë lokale.

Përveç fokusit të fëmijëve të prekur, me rëndësi është të theksohet edhe mbështeta për prindërit. Ata jo vetëm që duhet të kenë edukim sesi të kujdesen më mirë për fëmijët e tyre në mjedis shtëpiak, por po ashtu duhet të kenë guxim të kërkojnë shërbime më të mira për fëmijët e tyre. Kurset e shkrim-leximit mundësohen për nënat që janë analfabete, që ato të mund t'u lexojnë fëmijëve të tyre: të kenë qasje më të mirë në informacionet e shkruara për edukimin e fëmijëve, si dhe të vetëdijesohen më shumë për të drejtat dhe mundësitë e tyre. Zbatimi i SMZHH-së (pika 4) tregon se qendrat për ZHHF, pavarësisht sa janë joformale, ato në asnjë mënyrë nuk mbesin prapa kur bëhet fjalë për përdorimin e instrumenteve të përparuara. Faktikisht në shumë vende ky tip i dhënësve të shërbimeve për ZHHF mëtojnë të jenë më inovativë se dhënësit tradicionalë të atyre shërbimeve, përfshirë edhe sektorin privat (van Ravens, 2009, 2010a, 2010c). Pika e fundit po ashtu flet për një karakteristikë tipike të qendrave për ZHHF: ngritjen e vetëdijes. Qendrat për ZHHF asnjëherë nuk paraqiten vetvetiu; ato çdoherë inkuadrohen përmes një procesi të mobilizimit të bashkësisë. Ndërtimi i këtij tipi të kapitalit dhe rjetit social rreth qendrës për ZHHF paraqet kusht për qëndrueshmërinë e tyre: bashkësitë dhe anëtarët e bashkësive do ta sigurojnë vazhdimësinë e qendrës për ZHHF – në aspekt financiar dhe përmes sigurimit të të mirave – nëse besojnë se qendra është e patjetërsueshme dhe nëse kanë besim në gatishmërinë e ndërsjellë që ta mbështesin qendrën.

## Shërbimet dhe regjistrimi i fëmijëve në qendrat për ZHHF

UNICEF-i momentalisht i mbështet 22 qendra për ZHHF, të cilat gjenden në zonat më të marginalizuara. Gjendja e katër qendrave të tjera është e ndryshueshme. Sipas vlerësimit të paradokohshëm, që ishte bërë me kërkesë të UNICEF-it, tërhiqet vërejtja se në disa raste (21%) hapësira nuk është më shumë funksionale, ndërsa në raste të tjera hapësira përdoret për qëllime të tjera, e jo për ZHHF. Por, konstatimi i përgjithshëm është se qendrat mund të kthehen shumë lehtë në funksion të qendrave për ZHHF, nëse vendosen arazhmane financiare që ashtu të sigurohet mbulimi i shpenzimeve operative.

Në prill të vitit 2010 ishte bërë një analizë më e thellë në 17 prej gjithsej 22 qendrave që janë mbështetur nga UNICEF-i (Janeva, 2010). Qendrat në përgjithësi nuk disponojnë me mjete të mjaftueshme financiare dhe vuajnë nga mungesa e materialeve mësimore, kapaciteteve sanitare, mundësive për lojë jashtë etj. Komunitat marrin përsipër përgjegjësinë që të sigurojnë hapësirë, por shumë rrallë ndihmojnë për shpenzimet operative, siç janë rrogat dhe materialet. Gjatë vizitave në terren, që ishin zbatuar për qëllimet e këtij raporti në qershor në vitin 2010, po ashtu ishte vërejtur një pasqyrë e

përzier, ku bashkësitë më të pasura, siç është Manastiri, japin më shumë mbështetje për qendrat, për dallim prej bashkësive më të varfra, si Radovishi. Ashtu siç u tha më sipër, në kapitullin 6 të këtij raporti do të bëhet një vlerësim për koston e funksionimi të një qendre për ZHHF me kusht që të përmbushen disa kushte për cilësi.

Tash do t'i shqyrtojnë shërbimet që ofrohen në qendra. Nga vlerësimi i thellë, që ishte bërë, doli pasqyra vijuese sipas grupmoshave.

- **Mosha 0-1.** Disa qendra realizojnë vizita një herë në muaj.
- **Mosha 1-3.** Prindërit mblidhen dy herë në muaj në sesione grupore.
- **Mosha 3-6.** Fëmijët vijnë në qendra për aktivitete individuale dhe grupore për mësim. Disa qendra vazhdojnë të bëjnë edukimin e prindërve për këtë grupmoshë.

Tabela 3, që po ashtu i referohet vlerësimit në 17 qendra, përmban informacione për numrin e fëmijëve që janë përfshirë në qendra, si dhe numrin e orëve që i kalojnë fëmijët e moshës 3-6 vjeçare në qendra gjatë një jave.

Nga Tabela 3 mund të shihet se numri i përgjithshëm i fëmijëve që janë të regjistruar në këto 17 qendra është rreth 800. Thuaja një e treta e këtij numri të fëmijëve janë të moshës 0-3-vjeçare dhe dy të tretat janë fëmijët të moshës 3-6 vjeçare. Mesatarisht, në qendra regjistrohen nga 47.6 fëmijë, nga 20 (Gabrevcë, Lubnicë në Radovish dhe Lubnicë në Manastir) deri në 85 (Topok), 89 (Topaanë) dhe 200 (Sllatinë).

Fëmijët e moshës 3-6-vjeçare në të shumtën e rasteve i kalojnë nga 10 orë në javë në qendra, që rëndom janë të shtrira në 5 ditë. Sesionet që zgjasin nga 2 orë mbahen njësoj për fëmijët e moshës 3-vjeçare, për fëmijët e moshës 4-vjeçare dhe për fëmijët e moshës 5-vjeçare, gjë që rezulton me gjashtë orë të njëpasnjëshme për arsimtarin. Bashkë me aktivitetet që zbatohen për fëmijët e moshës nën 3 vjeç, vëllimi i përgjithshëm i punës së arsimtarit është faktikisht angazhim me orar të plotë. Varësisht nga madhësia e grupeve dhe varësisht nga gjendja financiare, arsimtarët punojnë individualisht ose në çifte.

**Tabela 3:** Numri i fëmijëve të regjistruar dhe orët gjatë një jave për fëmijë në 17 qendra për ZHHF, 20100

Komuna dhe qendra	Numri i fëmijëve të regjistruar sipas moshës		Numri i orëve për fëmijën në një javë
	Mosha 0-3	Mosha 3-6	Mosha 3-6
<b>Komuna Tetovë:</b>			
Slatinë	84	116	
Potok	39	46	10
Teqe	30	30	
<b>Komuna Radovish:</b>			
Podarësh	9	44	10
Shein Maale	8	33	
Gabrevcë	8	11	
Lubnicë	12	9	
Konçe	14	35	
<b>Komuna Shtip:</b>			
Lagja Babi	9	35	10
Radanski Pat	16	41	
Obleshevë	14	29	
Koçanë	11	37	
<b>Komuna Manastir:</b>			
Bair	40	28	10
Logovardi	31	15	10
Lubnica	12	9	20
Orizarë	3	23	10
<b>Komuna Çair:</b>			
Topaanë	25	64	10
Gjithsej	279	530	
Mesatarja për qendër	16.4	31.2	
Gjithsej (të gjitha moshat)	809		
Për qendër (të gjitha moshat)	47.6		

**Burimi:** Janeva, 2010

Tash për tash mbetet edhe një çështje që duhet të shqyrtohet: kontrasti i shprehur ndërmjet programit 2-orësh që u ofrohet fëmijëve në qendra dhe programit tërëditor që rëndom ofrohet për KF-të e rregullta. A është i mjaftueshëm një program 2-orësh gjatë ditës që të fitohet nxitja zhvillimore e dëshirueshme për këta fëmijë?

Dy orë në ditë – ose 10 orë gjatë një jave – mund të jetë shumë afër limitit. Rrëfimi është shumë më i mirë nëse programet janë gjysmëditore, nëse arsimtari punon me fëmijët 3

orë në ditë – ose 15 orë në javë – dhe ka në disponim një orë plotësuese për përgatitje dhe ndërveprim me prindërit, që na lejon të konstatojmë se angazhimi i arsimtarit është me gjysmë orari, pra vetëm me 4 orë. Me qëllim që të bëhet një krahasim ndërmjet ndikimeve të këtij modeli ndaj zhvillimit të fëmijëve me ndikimet e programeve tërëditore, për këtë ishte një pasqyrë e literaturës së përgjithshme ndërkombëtare<sup>3</sup>.

Përfundimi kryesor që buron nga kjo pasqyrë është se në aspekt të zhvillimit të fëmijës programet gjysmëditore janë po aq të mira sa programet tërëditore. Një nga shkaqet është se me programin e KF-ve formale – ashtu siç mund të gjendet nëpër gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore, si dhe ish-vendet e Bashkimit Sovjetik – zakonisht kufizohen aktivitetet me të cilat nxitet zhvillimi i fëmijës vetëm në disa orë gjatë mëngjesit. Ne pjesën tjetër të kohës fëmijët hanë, flenë ose janë të inkuadruar në aktivitete që mund të bëhen edhe jashtë programit. Fëmijët që ndjekin programin për ZHHF në orët e mëngjesit, ndërsa që e kalojnë pasditen në mjedis tjetër – p.sh.: me moshatarët e tyre ose me familjen – kanë më shumë dobi nga ndryshimi i mjedisit për mësim, me çka shpjegohet arsyeja se pse në disa studime thuhet se programet gjysmëditore janë më të mira se programet tërëditore. Me këtë rast duhet të përsëritet se kjo “funksionon” vetëm nëse mjedisi ku fëmija e kalon pjesën tjetër të ditës është i qëlluar për lojë, për mësim dhe, në përgjithësi, për zhvillimin e fëmijës. Këtu buron edhe rëndësia dhe mbështetja për prindërit (shih kapitullin 2). Thënë në mënyrë ironike, fëmijët më të privilegjuar që tash e kalojnë gjithë ditën në KF, do të kishin mjedis më të mirë që në drektë të vijnë në shtëpi sesa fëmijët që nuk kanë fare qasje në KF...

Këto dhe ide të tjera janë hyrje në kapitullin vijues, i cili faktikisht është pika themelore e këtij raporti. Në bazë të katër kapitujve të kaluar dhe në pajtim me mendimet vijuese për udhëheqjen dhe financimin në Maqedoni, kapitulli i ardhëm e formulon parimin e politikës themelore që mund t'i prijë zgjerimit me programe për ZHHF në një të ardhme të afërt.

---

3 Pasqyra e literaturës mund të gjendet në studimin e arsimit parashkollor për Kirgizinë (van Ravens, 2010c:32-34). Ajo pasqyrë bazohet në studimet e bëra për vendet në tranzicion (MacLean and Orozova, 2007; Evans, 2008; Comenius Foundation for Child Development, 2009) dhe në vendet e rajonit të OZHBE (Sammons et al, 2007; Reynolds and Temple, 2008).



## Parimet e politikës së zgjerimit të qasjes

**F***er-lojë*. Kjo moto, që në veçanti vlerësohet në botën e sportit dhe lojërave, mund të jetë një metaforë e dobishme edhe në kontekst të ZHHF-ve. Në mikronivel kjo mund t'i referohet një grupi të njerëzve që rriten bashkë në një fshat ose në një bashkësi vendore. Për ta, *fer-lojë* nënkupton respekt të ndërsjellë dhe ndershmëri gjatë ndërveprimit. Në nivel të politikës, kjo mund të nënkuptohet se të gjithë ata fëmijë kanë qasje të njëjtë në lojë, në mësim ose në zhvillim, kjo në kuptim më të gjerë. Kjo na shpie deri në makronivel. Këtu *fer-lojë* mund të përkthehet si *drejtësi sociale*: ndarje e drejtë e resurseve publike, të cilat janë të dedikuara për sigurimin e shërbimeve themelore për fëmijët, pavarësisht nga të ardhurat, niveli arsimor i prindërve të tyre, përkatësia etnike, gjinia ose kriteret e tjera socio-ekonomike.

Ky kapitull ka për qëllim që idenë për *fer-lojë* ta shndërrojë në një grup konkret të parimeve të politikës, e cila do t'i prijë zgjerimit të ardhshëm dhe përmirësimit të shërbimeve në fëmijërinë e hershme në Maqedoni. Është e qartë se ato parime të politikës duhet të jenë në pajtueshmëri me parimet e përcaktuara për udhëheqje dhe financim: do të ishte gabim nëse aq thjeshtë miratohen dhe përshtaten aranzhmanet financiare për ZHHF të një vendi tjetër dhe si të tilla të zbatohen

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se duhet të kërcejmë në trenin që lëviz. Mënyrat zbatimit të udhëheqjes dhe financimit në Maqedoni akoma janë në lëvizje. Duke i lënë pas vetes sistemet që kanë ekzistuar në vitet e tranzicionit, Maqedonia është drejt një ardhmërie të re. Decentralizimi dhe inovacionet fiskale do të kenë vend qendror në atë ardhmëri, po ende nuk është plotësisht e qartë se si do të duken ato aranzhmane të reja.

Për fat të mirë, ne mund të mbështetemi në dy raporte të shkëlqyeshme që janë përgatitur nga zyra e UNDP-së në Shkup (Martinez-Vasquez, Timofeev and Feruglio, 2007 and Cyan, Martinez-Vazquez and Timofeev, 2009). Duke iu referuar në përgjithësi decentralizimit fiskal, në raportin e parë formulohen një spektër i gjerë i parimeve që ishin nxitje për shkrimin e këtij kapitulli – “Financimi i porosisë së drejtë të shërbimeve për të gjithë qytetarët” – ofron disa mjete mjaft të dobishme për financimin e aranzhmaneve për qasje universale në programet për ZHHF, që janë të dobishme për qëllimet e këtij raporti.


## “Puna e zakonshme” nuk është zgjidhje

Përfundimi i parë që duhet të nxirret është se ka pak mundësi të arrihet qasje universale në programet për ZHHF nëse vazhdohet me “punën e zakonshme”. Ashtu siç është paraqitur në Skicën 10, njësia shpenzim (përkatësisht shpenzim për një fëmijë në një vit) në KF-të e rregullta, është mjaft e lartë në Maqedoni, madje edhe kur kjo krahasohet me katër vendet e tjera që kanë sisteme të ngjashme për KF. Në Skicën 10 njësitë shpenzim për KF në pesë vende së pari janë ndryshuar nga valuta nacionale në dollarë amerikanë, e pastaj janë ndarë sipas të ardhurave për banor që të mundësohet krahasimi i njërive shpenzim. Pa këtë hap, njësitë shpenzim në vendet më të pasura normalisht çdoherë do të jenë më të larta, me çka mbulohen dallimet reale në shumën e shpenzimeve. Pas skicës vijon edhe një diskutim, i cili i paraprin shpjegimit për atë se si është bërë llogaritja e të dhënave.

Të dhënat e Skicës 10 që i referohen Maqedonisë bazohen vetëm në 35 komuna që marrin pjesë në të a.q. *subvencione bllok* për KF. Numri i madh i 43 komunave nuk kanë KF dhe nuk marrin kurrfarë mjetesh, ndërsa numri më i vogël i 6 komunave përfitojnë *subvencione të dedikuara*, të cilat thua janë gjithnjë janë më të vogla se subvencionet bllok. Për secilën nga 35 komunat që fitojnë subvencione bllok shuma e përgjithshme e parave për një vit (të dhëna nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale) ndahet me numrin e përgjithshëm të fëmijëve të regjistruar në vitin 2008 (të dhëna nga Enti Shtetëror i Statistikës). Prej këtu buron edhe subvencionin për fëmijë në një vit për secilën komunë.

Ky tregues është paraqitur në Skicën 11 (më poshtë) si kolonë e kuqe. Përveç dy dallimeve në anën e djathtë (Krushevë dhe M. Brod), dallimet e tjera janë të kufizuara. Shumica e komunave janë afër subvencionit *mesatar* për fëmijë, që arrin shumën 53.710 denarë. Variacione më të mëdha ka në kolonat e kaltra që e përfaqësojnë subvencionin bllok për fëmijë në një komunë, pavarësisht se a shkon fëmija në arsim parashkollor apo jo. Kjo flet për pabarazinë e madhe në regjistrimin e fëmijëve në programet parashkollore, madje edhe në 35 komuna që kanë privilegjin të kenë subvencione bllok.

**Skica 10:** Krahasimi i njësisë shpenzim për program tërëditor në KF si % e Bruto Prodhimit Vendor për banor në pesë vende




**Burimi:** shih tekstin më poshtë..

Që të llogaritet njësisë shpenzim, në shumën e subvencionit mesatar shtetëror për fëmijë që është 53.710 denarë patjetër duhet të shtohet edhe kompensimi që e paguajnë prindërit. Ai kompensim në nivel vjetor arrin në 17.880 denarë (1.490 denarë në muaj). Shuma e përgjithshme e këtyre dy komponentëve – nga shteti dhe nga prindërit – arrin në 71.590 denarë për fëmijë në një vit. Kjo është baza e shumës 44.4% për Maqedoninë në Skicën 10. Ose, me fjalë të tjera: *që një fëmijë të regjistrohet në program tërëditor në KF gjatë një viti kjo kushton thuaja sa gjysma e të ardhurave vjetore të një qytetari mesatar të Maqedonisë*<sup>4</sup>. Të dhënat e Skicës 4 për Armeninë dhe Kirgizinë (Van Ravens, 2008a and 2010c), për Poloninë (Comenius Foundation for Child Development, 2009) dhe për Moldavinë (Orivel, Ana and Tuhari, 2007) janë llogaritur në mënyrë të ndryshme. Mesatarja e tyre është 19.3%, që paraqet më pak se gjysmën e 44.4% të Maqedonisë.

4 E vëreni se të ardhurat për banor janë të ardhurat nacionale të ndara me të gjithë qytetarët në vend, përfshirë edhe atë që nuk kanë rrogë të tyre, siç janë fëmijët, personat e rritur që nuk punojnë, personat e pensionuar etj. Kjo do të thotë se një rrogë mesatare mund të jetë e barabartë me shumë dy ose tre herë më të madhe të të ardhurave për banori. Megjithatë mbetet fakti se të ardhurat për banor janë shumë e parave me të cilat e mban veten një qytetar mesatar i Maqedonisë gjatë një viti. Dhe, 44.4% nga ajo shumë shpenzohet për përkujdesje ditore të vetëm një fëmije në KF.

**Skica 11.** Subvencionet bllok për fëmijë të regjistruar (e kuqe) dhe për secilin fëmijë që jeton në komunë (e kaltër), 200808



**Burimet:** Enti Shtetëror i Statistikës dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

**Shënim:** 35 komunave janë radhitur sipas subvencioneve që i marrin për fëmijë të regjistruar (kolona e kuqe). Emrat e komunave nuk janë përfshirë për shkak të mungesës së hapësirës. Megjithatë, ajo që është e rëndësishme këtu është një trend i përgjithshëm: variacioni i kufizuar në subvencione për fëmijë të regjistruar, përballë variacioneve të shprehura në subvencione që jepen për secilin fëmijë, duke i theksuar pabarazitë më të parëndësishme, madje edhe te ato 35 komunave që janë mjaft të privileguara që të fitojnë bllok doatcione. Nëse të dhënat i përfshijnë edhe 6 komunave që fitojnë subvencione të dedikuara, në atë rast vetë ato do të gjenden në anën e majtë me kolona shumë më të ulëta. Në komunat e tjera nuk ka KF dhe ato nuk marrin subvencione; vlera e tyre në këtë paraqitje do të ishte zero.

Në bazë të informacioneve të dhëna më sipër, ka mundësi të bëhet një paraqitje në vija të trasha se sa do të kushtojë qasja e të gjithë fëmijëve të moshës 4 dhe 5-vjeçare sipas mënyrës së punës së zakonshme:

- Numri i të lindurve në Maqedoni është stabilizuar në rreth 22.500;
- 21% e fëmijëve të moshës 4-vjeçare dhe 24.5% e fëmijëve të moshës 5-vjeçare tashmë janë regjistruar (Tabela 2);
- Kështu numri i fëmijëve të moshës 4 dhe 5-vjeçare që janë lënë të papërfshirë është:  $(79 + 75.5) / 200 * 22,500 * 2 = 34,763$ ;
- Nëse ky numër i fëmijëve shumëzohet me njësinë shpenzim prej 71.590 denarë, del shpenzimi plotësues vjetor prej rreth 2.5 miliardë denarë (ose më saktë: 2.488.683,170 denarë) që paraqet rreth 40 milionë euro.
- Nga kjo shumë mund shlyhet kompensimi që e paguajnë prindërit, por duhet të kihet parasysh se shumica e familjeve që sot nuk janë të përfshira në KF nuk do të kenë mundësi të paguajnë kompensim të lartë, ashtu që zvogëlimi i atyre 2.5 miliardë denarë pagesë është i kufizuar.

## Programet gjysmëditore: më të mira dhe më të lira

Fotografia është krejt tjetër nëse shikohet mundësia për qasje universale për fëmijët e moshës 4 dhe 5-vjeçare përmes sigurimit të *programeve gjysmëditore* me rreth 3 orë në ditë, pa ushqim dhe pa fjetje. Ndonëse në kapitullin 6 të raportit është bërë një llogaritje e hollësishme e njësisë shpenzim për këto programe në Maqedoni, përvojat e vendeve të tjera të rajonit të EQL/Komonuellit të Shteteve të Pavarura dëshmojnë se njësia shpenzim për program tërëditor është rreth katër herë më e ulët se njësia shpenzim për qëndrim tërëditor në KF, siç është paraqitur në Tabelën 4.

**Tabela 4:** Dallimet e njësisë shpenzim ndërmjet programeve tërëditore dhe gjysmëditore në tre vendet e EQL/Komonuellit të Shteteve të Pavarura (2007/2008)

	Valuta	Njësia shpenzim për program tërëditor	Njësia shpenzim për program gjysmëditor	Shkalla
Armenia	US\$	216	34.2	6.32
Kirgizia	Som	6010	1670	3.60
Polonia	Zloty	4500	1200	3.75

**Burimet:** Van Ravens, 2008a and 2010c, and Comenius Foundation for Child Development, 2009

Prandaj në vend që ta shqyrtojmë shumë e çmimit prej 2.5 miliardë denarë, tash do ta shqyrtojmë shumë prej 0.6 miliardë denarë sipas radhitjes për nga madhësia. Nëse shprehemi në mënyrë hipotetike, kjo shumë mund të zvogëlohet edhe më tej nëse programet momentale tërëditore për KF do të ndërroheshin me programe tërëditore<sup>5</sup>. Realisht as buxheti aktual i KF-ve prej 1.100 denarë nuk do të ishte i mjaftueshëm që të përfshihen më shumë se 60.000 fëmijët që sot jetojnë në Maqedoni, që nuk është larg numrit të 67.500 fëmijëve të moshës 3, 4 dhe 5-vjeçare.

Duke e pasur parasysh faktin se programet gjysmëditore janë po aq të mira – nëse jo edhe më të mira – sa programet tërëditore kur është fjala për zhvillimin e fëmijës (ashtu siç ishte theksuar në kapitullin 4), ky është një argument i fuqishëm, i cili do të promovohet në programet gjysmëditore. Ato janë më të mira dhe më lira.

5 Shuma e përgjithshme e parave që janë harxhuar për subvencione bllok është 1.080.000.000, ndërsa shuma për subvencionet e dedikuara është 20.000.000 denarë. Shuma e përgjithshme e dy subvencioneve është 1.100.000.000 denarë. (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 114/09). Nëse kjo shumë pjesëtohet me një të katërtën e shumës së përgjithshme të njësisë shpenzim për qëndrim tërëditor nga 70.000 denarë, del se janë përfshirë 62.857 fëmijë.

Por, nënkuptohet se problem paraqet ajo që programet tërëditore kanë edhe funksion dytësor përveç zhvillimit të fëmijës. Kjo ka të bëjë me faktin se prindërit janë më të lirë – madje në disa vende edhe vëllezërit e motrat më të mëdhenj – nga nevoja që të kujdesen për fëmijët, që do të thotë se ata mund të punojnë, të studiojnë ose të kenë më shumë kohë të lirë. Kjo shpie në thelbin e çështjes politike: ai funksion sekondar – të cilin do ta quajmë *funksion të përkujdesjes* që dallohet nga funksioni zhvillimor – a paraqet funksion themelor shoqëror për të cilin është i arsyeshëm shpenzimi i tillë publik? Apo ndoshta jo?

Ekzistojnë dy situata në të cilat përgjigja e kësaj pyetje do të ishte pozitive

- Në vendet me varfëri të theksuar shpeshherë dy prindër duhet të realizojnë të ardhura që të mund të mbijetojnë; kjo vlen edhe për prindërit e ndarë. Nëse ata nuk mund t'ia lejojnë vetvetes të paguajnë për përkujdesje ditore të fëmijëve të tyre, për këtë detyrohen të ngarkohen vëllezërit e motrat më të rritur, ndërsa ata pastaj janë të penguar të shkojnë në shkollë. Në rrethana të tilla shtetet ndonjëherë mbështetin programe tërëditore themelore me mjete publike. Megjithatë rrethanat e tilla nuk vlejnë gjithnjë për të gjitha familjet që përdorin KF në Maqedoni në këtë moment. Në kapitullin 5 ishte theksuar fakti se klientët e KF-ve zakonisht janë nga rajonet urbane dhe se ata janë njerëz që kanë arsimim të mirë dhe të cilët realizojnë të ardhura të mira. Në fakt, në raportin e përgatitur nga Janeva, Petroska-Beshka dhe Eminovska (2009) thuhet se 75% e fëmijëve të çerdheve të fëmijëve dhe 72% e fëmijëve të grupeve të tjera në KF janë nga familjet që kanë të ardhura të dyfishta – nga të dy prindërit. Në vendin që ka papunësinë të lartë ku shumë familje nuk kanë asnjë burim të të ardhurave, familjet që kanë të ardhura nga të dy prindërit janë vërtet grup i familjeve të zgjedhura. Ata shumë lehtë mund t'ia lejojnë vetvetes të paguajnë edhe kompensim më të lartë, si dhe gjithë shumën e kompensimit. Në vende të tjera ata zakonisht janë klientë të kopshteve private për fëmijë.
- Situata e dytë me të cilin arsyetohet shpenzimi i mjeteve publike për kapacitetet e përkujdesjes ditore të fëmijëve janë mungesat e tregut të fuqisë së punës. Nëse punëdhënësit nuk kanë kuadër të mjaftueshëm me çka pengohet zhvillimi ekonomik dhe nëse angazhimet e tyre personale për sigurimin e përkujdesjes ditore janë të pamjaftueshme, përmes financimit publik të përkujdesjes ditore do t'u mundësohet prindërve që nuk janë të punësuar – më shpesh nënave – të pranojnë vend pune dhe në atë mënyrë të shërbejnë për qëllimin e përgjithshëm për zhvil-

limin ekonomik. Por, duhet të përsërisim se kjo rrethanë nuk mund të gjendet sot në Maqedoni. Ashtu siç ishte theksuar, shkalla e papunësisë në Maqedoni është më e larta në rajon, ashtu që sigurimi i punësimit për një anëtar të familjes paraqet sfidë serioze. Vetëm nëse punësimi i anëtarit të dytë të familjes është mundësi reale dhe nëse familja përsëri nuk mund ta paguajë kompensimin për përkujdesjen ditore të fëmijës, në atë rast do të sigurohej mbështetje nga mjetet publike.

Si përfundim: në rrethanat e dhëna *nevojitet që përparësia të vihet në funksionin e zhvillimit të fëmijëve, përballë funksionit të përkujdesjes ditore të fëmijëve*. Nuk ka argumente që do t'i jepnin përparësi funksionit përkujdesës për grupin e pakicës së pasur nëse funksioni i zhvillimit të fëmijës është plotësisht i papërbushur për shumicën e varfër.

Implikimet që burojnë nga ky përfundim janë se kur bëhet fjalë për financim me mjete publike, zgjerimi i *mëtejme* i programeve për ZHHF tash për tash duhet të orientohet në programe gjysmëditore. Implikim tjetër *mund* të jetë ajo se nëse prindërit dëshirojnë përkujdesje ditore të fëmijëve të tyre, në atë rast duhet të paguajnë për gjithçka që paraqet më shumë se program gjysmëditor: ushqim, fjetje dhe aktivitete plotësuese. Këto “plotësime” do të ishin çështje e vendimit personal, siç është në shumë vende të tjera. Është e qatë se ky parim i “pagesës së aktiviteteve plotësuese” do të ketë implikime të rëndësishme si për vetë KF-të, ashtu edhe për prindërit që momentalisht i përdorin shërbimet e kopshteve të fëmijëve. Së pari do të shqyrtojmë implikimet që kanë të bëjnë me KF-të.

## Implikimet për KF

Principi “i pagesës për aktivitete plotësuese” nuk do të thotë se kjo do të ketë ndikim në mënyrën e funksionimit momental të KF-ve. Pjesa e financimit publik (programet gjysmëditore për zhvillim të fëmijëve) dhe pjesa që financohet në mënyrë private (aktivitetet plotësuese) mund të ofrohen në kombinim. Nuk ka arsye pse një institucion nuk do të ofronte programe gjysmëditore për zhvillimin e fëmijëve dhe përkujdesjen tërëditore në një program të integruar. Në esencë ajo është ajo që KF-të e kanë bërë çdoherë. Tash ndryshon vetëm rrjedha e parave: financimi i programeve gjysmëditore për zhvillimin e fëmijëve të vendeve publike dhe mundësia e pagesës së kompensimit të vogël nga konsumatorët, ndërsa prindërit (ose punëdhënësit e tyre) paguajnë për të gjitha aktivitetet plotësuese.

Në fakt, si rezultat i politikës së propozuar, kopshtet e fëmijëve mund të jenë të zëna si asnjëherë më parë. Kërkesa për programe gjysmëditore për zhvillimin e fëmijëve

do të jetë shumë e madhe. Pjesërisht për shkak se ajo politikë do të jetë e kënaqur nga zgjerimi i qendrave për ZHHF, por ka shumë mundësi që KF-të aktuale po ashtu të marrin hise të madhe në këtë treg. Disa prej tyre mund të shtojnë nga disa grupe gjysmëditore në kuadër të aktiviteteve aktuale, disa prej tyre mund t'i zëvendësojnë (një pjesë nga) aktivitetet për përkujdesje me aktivitete për zhvillimin e fëmijëve; por në të dyja rastet puna e të punësuarve në KF do të jetë më interesante dhe më e vlerësuar. Disa nga të punësuarit nuk do të ndërrojnë më pelena dhe do të fillojnë t'i edukojnë fëmijët.

Po ashtu mund të supozohet se KF-të aktuale do ta marrin funksionin e qendrës së resurseve, që i mbështet qendrat e reja për ZHHF. Qendrat do të kenë nevojë më të madhe për mbikëqyrje, trajnim në vendin e punës dhe plane dhe materiale të azhuruara mësimore. KF-të janë në pozicion të shkëlqyeshëm që t'i përmbushin të gjitha këto funksione. Në fund, rritja e shpejtë e programeve për ZHHF në Maqedoni mund të krijojë edhe kërkesë të madhe për trajnime para punësimit dhe pjesërisht kjo mund të kalojë në “biznes të ri” për KF; për shembull ato mund të jenë vende në të cilat do të ushtrohen praktikantë të fakulteteve pedagogjike.

Thënë ndryshe: nëse vendoset se programet gjysmëditore mund të sigurohen nga qendrat për ZHHF dhe KF-të aktuale, nuk ka asnjë arsye që ofruesit e tjerë potencialë të këtyre shërbimeve të mos jenë të përfshirë, siç janë shkollat, qendrat në komunitete, KF-të private dhe kapacitetet në kushte familjare. Në atë rast se parimi i politikës do të ishte se *akreditimi* paraqet parakusht për të marrë mjete për programe gjysmëditor dhe se secili institucion – publik, privat ose fetare – që është i përgatitur dhe ka mundësi t'i përmbushë kriteret, të marrë akreditim dhe të ketë qasje në këtë “situatë të mundësive të barabarta”, si do ta quanin ekonomistët. Qysh në fillim nuk duhet të ketë përjashtime/mospërfshirje. KF-të mund të ketë rol edhe në sistemin e akreditimit, për shembull, të marrin pjesë në realizimin e akreditimit.

## Implikimet për konsumatorët momentalë të programeve tërëditore në KF

Njerëz të ndryshëm që ishin konsultuar për këtë raport kanë theksuar se nëse principi “i pagesës për aktivitete plotësuese” në KF-të aktuale vendoset brenda natës, ai do të hasë në rezistencë të fuqishme nga klientët e KF-ve. Ata mendojnë se programet tërëditore janë në rregull dhe mbase nuk janë të vetëdijshëm se kompensimi që e paguajnë për programe tërëditore paraqet vetëm një pjesë nga shumata e shpenzimeve. Fakti se grupet e vendeve të tjera, me të cilët mund të krahasohen, paguajnë çmim

shumë më të lartë, për ta nuk është relevant; ata thjesht nuk duan ta humbin privilegjin e tyre.

Kjo është një dilemë e rëndësishme. Nga njëra anë, nëse njerëzit e pasur paguajnë çmim korrekt për shërbimet, që në bazë janë private, do të paraqesë shembull të mirë për të drejtat sociale dhe kjo mund të lirojë një sasi të konsiderueshme të resurseve publike që nevojiten për t'u përfshirë secili fëmijë me programe gjysmëditore. Në fakt, kjo do të jetë e mjaftueshme, siç e pamë më sipër (në tekstin e Tabelës 4). Nga ana tjetër një plan për të cilin me siguri dihet se do të hasë në rezistencë është njëherazi i ekspozuar ndaj rrezikut të dështimit. Ky raport sigurisht nuk do ta zgjidhë këtë dilemë, sepse ajo në esencë është dilemë politike: a ka vullnet politik që të zgjidhet rezistenca e tillë apo jo? Por, me këtë raport do të bëhet përpjekje që të arrihet fleksibilitet dhe të paraqiten një numër i caktuar i skenarëve, me ç'rast secili prej tyre ka një përfundim politik. Nga kjo arsye do të shërbehemi me instrumentin e quajtur “mënyrë dinamike e kombinimit të financimit”.

## Mënyra dinamike e kombinimit të financimit

Mënyrat e financimit të ZHF-ve shpeshherë bazohen në burime të ndryshme të parave. Në bazë të këtij kapitulli dhe në bazë të literaturës për ZHHF të bazuar në komunitet, i identifikojmë pesë burime. Këto pesë burime bashkërisht do të duhet t'i mobilizojnë resurset e nevojshme, por mënyra e “përzierjes ose kombinimit” të tyre mund të dallohet. Kjo do të thotë se derisa secila pjesë e tyre të plotësohet 100%, secili prej atyre kombinimeve do të funksionojë. Përveç kësaj, kombinimet e tilla me kalimin e kohës mund të ndërrohen: një ose dy palë që kanë dhënë kontribut gradualisht mund të tërhiqen, ndërsa të tjerat që janë më të rëndësishme mund të mbeten. Kombinimet e ndryshme paraqesin skenarë të ndryshëm. Por, ajo çështje do të shqyrtohet në kapitullin vijues. Këtu do t'i shqyrtojmë të gjitha pesë burimet:

- **Qeveria.** Nëse pranojmë që programi gjysmëditor për zhvillimin e fëmijëve të paraqesë shërbim themelor social – si format e tjera të edukimit, mbrojtjes shëndetësore etj. – atëherë mbështetja financiare duhet të ekzistojë patjetër. Kjo do të ishte *e drejtë e nënkuptueshme*. Se sa në mënyrë precize do të ndahen përgjegjësitë ndërqeveritare (ndërmjet Qeverisë dhe komunave) kjo varet nga zhvillimi i mëtejshëm i decentralizimit fiskal në Maqedoni, që në këtë fazë është vështirë të parashikohet. Por, në përgjithësi është e qartë se Qeveria duhet të kontribuojë. Është sfidë të gjenden resurse plotësuese (nga burimet që janë dhënë më poshtë) që ngarkesa e Qeverisë të lehtësohet.

- Pagesa varësisht nga të ardhurat e prindërve. Përvojat e qendrave për ZHHF në Maqedoni dhe në vende të tjera dëshmojnë se prindërit shpeshherë janë të përgatitur të kontribuojnë si në aspekt financiar, por edhe me tipa të tjerë të mjeteve për një lloj të programeve që janë prezantuar me këtë raport. Ndonëse mospagesa e kompensimit për programin për zhvillim të fëmijëve nuk është në pajtueshmëri të plotë me faktin se arsimit fillor dhe shërbimet shëndetësore janë falas, megjithatë mund të shqyrtohet mundësia për vendosjen e një kompensimi të caktuar për konsumatorët që ashtu të zvogëlohet ngarkesa financiare për Qeverinë. Ashtu si kalon koha, gjendja financiare në Maqedonia përmirësohet dhe prandaj mund të paramendohet se edhe ai kompensim do të zvogëlohet. Madje, një ditë sigurisht do të hiqet plotësisht.

Megjithatë edhe përkundër faktit se prindërit janë të përgatitur të paguajnë kompensim, ata jo gjithnjë janë në gjendje ta bëjnë atë. Që këtu kompensimi nga konsumatorët mund të sjellë largim të fëmijëve më të varfër, të cilët zakonisht kanë më shumë nevojë për këso shërbimesh. Një zgjidhje e përgjithshme do të ishte vendosja e kompensimit sipas të ardhurave: përkatësisht që secili kompensim të varet nga të ardhurat e prindërve. Kjo mund të zbatohet në mënyrë të sofistikuar, përmes përkufizimit të më shumë kategorive të të ardhurave dhe pagesës së kompensimit të ndryshëm për secilën prej atyre kategorive. Ose, edhe më thjeshtë – fëmijët e varfër do të jenë plotësisht të liruar nga pagesa e kompensimit, ndërsa të gjithë të tjerët do të paguajnë një kompensim të njëjtë (ashtu siç veprohet në disa qendra për ZHHF). Në këtë raport do të përpunohet opsioni i dytë, duke e pasur parasysh se në punën e mëtejme mund të zhvillohen skema më të mira të planeve që propozohen me këtë raport.

- Dobitë për ZHHF-të nga puna efikase. Ashtu siç ishte theksuar më parë në këtë raport, njësia shpenzim për programin tërëditor në KF është 44.4% nga të ardhurat për banor, ndërsa në katër vendet e tjera të rajonit të EQL/Komonuellit të Shteteve të Pavarura kjo mesatare është 19.3%. Janeva, Petrovska-Beshka dhe Eminovska (2009) gjetën shpjegim të mundshëm për shpenzimet e larta në Maqedoni për të dalat që e dëmtojnë sistemin, siç janë: (i) punësimi i tepërt,<sup>7</sup> (ii) sigurimi i sasive të

7 Dëshmi se po sigurohet kuadër krejt pa nevojë është punësimi i administratorit më orar të plotë në KF, ku ka njëzet deri në tridhjetë fëmijë. Në vitin 2008 shkalla e kuadrit pedagogjik në raport me fëmijët ishte shumë normale në 1:19.6, në shkallën e personelit të përgjithshëm në raport me fëmijët (përfshirë edhe personelin teknik) ishte 1:10.8. Kjo flet se ka pasur aq personel teknik sa edhe kuadër pedagogjik. Burimi i këtyre të dhënave është dhënë në këtë fusnotë: Enti Shtetëror i Statistikës, Pasqyra statistikore nr. 2.4.9.02/614.

tepërta të ushqimit dhe (iii) inkuadrimi “i fëmijëve të paqenë” në raporte financiare<sup>8</sup>. Zafeirakou (2006:34-35) në raport përmend parregullsi të këtitlla. Duket se është e arsyeshme që KF-të t'i zvogëlojnë të dalat e tyre që përfitimet nga efikasiteti të mundësojnë zgjerim të programeve gjysmëditore.

- Inkuadrimi gradual i principit “të pagesës për aktivitete plotësuese” në KF-të aktuale. Ashtu siç ishte theksuar, në aspekt të politikës, rritja e kompensimit për programet aktuale tërëditore në KF paraqet çështje shumë të ndjeshme. Megjithatë nuk është e drejtë ndaj parimeve të drejtësisë sociale që mos të kërkohet nga grupet e privilegjuara që të heqin dorë nga një pjesë e privilegjeve të tyre që ashtu të mbështetet procesi i zgjerimit të grupeve që në këtë moment janë të mënjanuara nga shërbimet themelore. Në raport me atë se sa duhet të jetë i madh ai kontribut, mbetet të bisedohet, si dhe në lidhje me çështjen se si duhet të jetë kombinimi i financimit.
- Sektori privat. Veprimtarët privatë mund të kenë role të ndryshme në sigurimin e ZHHF-ve. Ata mund të jenë ofrues të shërbimeve (ndaj KF-ve private); ata mund t'i ofrojnë kapacitetet e tyre në kompani; mund të ofrojnë subvencione për të punësuarit e tyre, ashtu që kompensimi që duhet të paguhet ndaj KF-ve do të jetë i përbalueshëm. Megjithatë, kontributi më i madh i sektorit privat për ZHHF zakonisht jepet nën mbulesën e Përgjegjësisë Korporative Sociale (CSR). Duke e ndjerë përgjegjësinë e mirëqenies së fëmijëve, kompanitë mund të japin kontribut të rëndësishëm në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar. Megjithatë ato shfaqin preferencë për mbulimin e shpenzimeve elementare (të p.sh.: investimeve kapitale në shkollë) në vend për mbulimin e shpenzimeve operative. Shpenzimet operative duhet të mbulohen nga burime më të strukturuar, siç janë qeveritë, bashkësitë dhe familjet.

## Rezimeja e këtij kapitulli

Rezimeja e parimeve të politikës që ishte përpunuar në këtë kapitull është kjo:

- Kur bëhet fjalë për politikën qeveritare, zgjerimi i ardhshëm i ZHHF-ve do të jetë me programe gjysmëditore që janë të orientuara drejt zhvillimit të fëmijës. Kjo paraqet shërbim publik dhe është një e drejtë e merituar.

---

8 Fëmijët e paqenë – janë fëmijët që nuk shkojnë në KF ose që s'ekzistojnë fare – zakonisht ata fëmijë paraqiten që ashtu të merren më shumë mjete nga dotacionet që shkojnë në KF.

- Kur bëhet fjalë për kërkesën për zgjerim të përkujdesjes ditore, kjo në esencë është çështje private. Në parim prindërit do t'i paguajnë shpenzimet plotësuese, siç janë: ushqimet, vendet për fjetje dhe aktivitetet e tjera plotësuese. Shkalla deri ku do të rritet kompensimi për përkujdesje ditore në KF-të aktual është çështje themelore e politikave, por ajo do të ishte e drejtë edhe në aspekt të drejtësisë sociale.
- Akreditimi paraqet kusht që të fitohet financimi për sigurimin e programeve gjysmëditore. Por, këtu bëhet fjalë për ofrim të shërbimeve të barabarta. Secili institucion që i përmbush kushtet, mund të marrë akreditim: qoftë publik apo privat, aktual apo i ri; dhe, për secilin fëmijë.
- Financimi do të sigurohet nga kombinimi i pesë burimeve:
  - Qeveria
  - Kompensimi që paguhet sipas të ardhurave të prindërve
  - Përfitimet e KF-ve aktuale nga efikasiteti i tyre
  - Rritja e kompensimit që paguhet për programe tërëditore në KF
  - Sektori privat

Ky grup i parimeve për politikën janë përpunuar në dy kapitujt vijues. Në kapitullin 6 është bërë vlerësimi i shpenzimeve për politikën e propozuar, ndërsa në kapitullin 7 është dëshmuar se kjo mund të financohet në mënyrë të qëndrueshme.

## Shpenzimet e sigurimit të qasjes universale për fëmijët e moshës 4 dhe 5-vjeçare

**A** mund të lejojnë Qeveria dhe qytetarët e Maqedonisë në aspekt *strukturor* qasje universale për të gjithë fëmijët e moshës 4 dhe 5-vjeçare në programet gjysmëditore për zhvillimin e fëmijës? Që të jepet përgjigje në këtë pyetje, patjetër duhet të bëjmë vlerësim të mirë për atë se sa do të kushtonte kjo. Për këtë do të shërbehemi me qasjen e propozuar nga zyra e UNICEF-it në Shkup.

Në këtë koment resurset qeveritare për ZHHF shpërndahen vetëm në bazë të *ekzistimit të objektit fizik* (Martinez-Vasquez, Timofeev and Feruglio, 2007:vii) në vend në bazë të nevojave të njerëzve. Kjo shpie drejt dallimit në bazë të ruralitetit (ibidem), që po ashtu nënkupton dallim edhe në sigurimin e shërbimeve për të varfrit dhe grupet e pakicave. Kjo qasje e vjetruar duhet të zëvendësohet me *normat e shpenzimeve për klient* (Cyan, Martinez-Vazquez and Timofeev, 2009:iv). Kjo do të thotë se secili klient – në rastin tonë për secilin fëmijë të moshës 4 dhe 5-vjeçare – duhet të vihet në disponim të një shume të caktuar të parave që ashtu të mbulohen shpenzimet reale për shërbimin. Formula e propozuar nga UNDP-ja është kjo:

$$\text{Exp-i} = \text{c-i} * \text{Norm} * \text{p-i}$$

(Cyan, Martinez-Vazquez and Timofeev, 2009:11) ku:

- **Exp** është shpenzimi i përgjithshëm nga qeveria për shërbimin dhënë
- **c** është faktori ose koeficienti me të cilin shumëzohet norma për shkak të rrethanave specifike. Për shembull, nëse dendësia e popullatës në një komunë të

caktuar është e vogël, shpenzimet mund të jenë 15% më të larta se në komunën ku dendësia e popullatës është mesatare (për shembull: mund të nevojitet të bëhet organizimi i transportit për fëmijët e lagjeve të largëta ose mund të nevojitet të pranohen edhe grupe më të vogla, që është edhe më shtrenjtë për një fëmijë). Për atë komunë c-ja do të jetë 1.15.

- **Norma** paraqet normën e shpenzimeve për klient, përkatësisht shumën që duhet të paguhet për një fëmijë në vit.
- **p** (nga popullata) paraqet grup qëllimor, gjegjësisht numrin e përgjithshëm të klientëve që mund të shërbehen në komunë. Në rastin tonë, ky është numri i fëmijëve të moshës 4 dhe 5-vjeçare në komunë, të cilët ende nuk janë regjistruar në KF.
- **i** (që i shtohet njësisë Exp, c dhe Norm) është në fakt komuna e dhënë. Kjo do të thotë se koeficienti c dhe numri i klientëve p janë specifike për një komunë të dhënë dhe se të dalat e përgjithshme (Exp) po ashtu dallohen në secilën komunë veçmas.

Për qëllimet e këtij raporti duhet të bëhet një përshtatje e kësaj formule

- Qeveria paraqet burimin e vetëm nga pesë burimet në kombinimin e financimit. Prandaj në fillim i kërkojmë *shpenzimet* e përgjithshme në vend të shpenzimit të përgjithshëm qeveritar. Në kapitullin 7 do të përpunohet se sa është saktë pjesa e Qeverisë.
- Do të bëjmë ndërrim “të normës” me “njësinë shpenzim”.
- Do ta kërcejmë i-në, sepse qëllimi i këtij raporti është të shqyrtohet qëndrueshmëria afatgjate në nivel *nacional*, por jo ende në nivel komunal.
- Në raport me koeficientet (c), ekzistojnë dy kritere relevante:
  - Dendësia e popullatës dallohet dukshëm ndërmjet komunave dhe kjo ka ndikim të fuqishëm ndaj shpenzimeve. Që këtu kemi koeficient “c-dendësia”. Kjo eventualisht do të llogaritet veçmas për secilën komunë dhe do të mundësojë kufizim ndërmjet komunave në raport me shpenzimet e financimit. Për qëllimet e këtij raporti para së gjithash duhet ta dimë se cilat janë implikimet e shpenzimeve në nivel *nacional*.
  - Sipas asaj që u tha në lidhje me kombinimin dinamik të financimit, kompensimi për program gjysmëditor paqetë duhet të jetë sipas të ardhurave të familjes që ashtu të shmanget dallimi i fëmijëve më të varfër. Në disa komuna ka më

shumë fëmijë të varfër se në disa të tjera. Megjithatë kjo do të shqyrtohet në këtë kapitull në pjesën e financimit, sepse kompensimi paraqet pjesë të financimit, e jo të shpenzimeve. Prandaj në këtë fazë nuk do ta përfshijnë koeficientin me të cilin do të përshtaten dallimet në shpenzime.

Tash formula duket kështu::

**Gjithsej shpenzime = p \* njësia shpenzim \* c-dendësia**

Në tre pjesët e tjera do të përpunohet secili prej këtyre tre faktorëve në formulë.

## Grupi qëllimor: numri i fëmijëve 4 dhe 5-vjeçarë që nuk janë regjistruar (p)


Në Skicën 12 tregohet se numri i fëmijëve të lindur në nivel vjetor në Maqedoni ka rënë nga vitit 1998<sup>9</sup> dhe është stabilizuar në pjesën e viteve të paradokohshme në nivelin prej 22.500 deri në 23.000 fëmijë.

Në botimin “Maqedonia në numra 2009” Enti Shtetëror i Statistikës (2009:8) edhe një herë e konfirmoi dinamikën e dobët të popullata. Shpërngulja (776) dhe vendosja në një vend tjetër (751) ishte më e baraspeshuar në vitin 2008. Me 22.500 deri në 23.000 fëmijë të lindur numri i fëmijëve katër/pesëvjeçarë sigurisht do të stabilizohet në 22.500, me çka do të arrihet në numrin 45.000 për të dyja grupmoshat bashkërisht.

Nga 45.000 fëmijë, 21% e fëmijëve të moshës katërvjeçare tashmë janë regjistruar në KF në vitin 2007, siç është paraqitur në Tabelën 2. Për fëmijët e moshës pesëvjeçare ajo përqindje është 24.5%. Është vështirë të vlerësohet se a do të ndryshojnë dhe në cilin drejtim do të ndryshojnë këto numra gjatë viteve të ardhshme. Në Tabelën 1 është treguar se numrat absolutë të fëmijëve katërvjeçarë të regjistruar janë në rritje të, por gjendja me fëmijët pesëvjeçarë është e kundërt. Duke e pasur parasysh fatin se nuk zhvillohen kurrfarë politikash që numri i fëmijëve të regjistruar në KF-të aktuale të rritet, supozojmë se numri i fëmijëve 4 dhe 5-vjeçarë të regjistruar edhe tash do të mbetet mesatarisht në nivelin e njëjtë. Kjo do të thotë se prej 45.000 fëmijëve të moshës 4 dhe 5-vjeçare rreth 22.75 (mesatarisht janë 21 dhe 24.5) tashmë do të regjistrohen, ashtu që 34.763 mbeten të përjashtuar nga grupi jonë qëllimor. Kjo në formulën tonë paraqet p.

9 Rënia e këtillë në fakt ka filluar shumë më herët. Për shembull, në vitin 1994 në nivel të fëmijëve të lindur ka qenë 33,487, edhe pse ky numër u referohet fëmijëve të lindur të Maqedonisë në vend dhe jashtë.

**Skica 12.** Numri fëmijëve të lindur në Maqedoni (1998-2008)



**Burime:** Enti Shtetëror i Statistikës dhe Enti i Mbrojtjes Shëndetësore për Nëna dhe Fëmijë

## Njësia shpenzim

Llogaritja e njësisë shpenzim për programin për ZHHF pjesërisht paraqet aktivitet empirik, e pjesërisht aktivitet normativ. Empirik është sepse çdoherë është mirë të shqyrtohen programet aktuale në jetën reale. Por, po ashtu paraqet edhe aktivitet normativ, sepse programet aktuale mund të jepen për programin e dhënë, siç ishte theksuar në lidhje me KF-të formale në Maqedoni në Kapitullin 5. Kjo po ashtu mund të nënkuptojë se janë investuar mjetet të pamjaftueshme në program. Rasti i tillë është me ZHHF-të në Maqedoni.

Janeva (2010) përshkruan një aspekt jo shumë të mirë të gjendjes në të cilën gjenden sot këto qendra. Ja një fragment i faqes 3 të raportit për vlerësim: “Më shumë se 40% nga hapësirat e vizituara nuk kanë as nyje sanitare, e as nuk disponojnë me pajisje minimale dhe materiale mësimore (didaktike) që të pasurohet ambienti në të cilin fëmijët qëndrojnë dhe ku i realizojnë aktivitetet e mësimin të hershëm. Edukatorët që punojnë në qendra, po ashtu kujdesen edhe për mirëmbajtjen e higjienës në qendra. Aktivitetet kryesisht zbatohen brenda në klasa (hapësira), ndërsa hapësira e jashtme dhe oborret nuk përdoren për aktivitete”. (fondi i fragmentit)

Prandaj në vend që thjesht të replikohen programet që nuk janë të financuara sa duhet, ne duhet të bëjmë një vlerësim se *sa do të kushtonin* këto programe nëse përmbushen

standarde të caktuara. Shumë ekspertë dhe njerëz të praktikës që u intervistuan për qëllimet e këtij raporti e theksuan nevojën e kornizës ligjore për programet për ZHHF, sepse korniza ligjore për KF-të formale është jorelevante, madje edhe për vetë KF-të formale. Kjo kornizë ligjore – që në mënyrë ideale do të bazohej në Standardet e Mësimit dhe Zhvillimit të Hershëm – do t'i përfshinte standardet që duhet të përmbushen përmes programeve, përkatësisht prej të cilave burojnë standardet për hapësirë, për inventar, për kualifikimet e arsimtarëve etj. Prandaj ato standarde operative mund të paraqesin edhe bazë fillestare për normat financiare.

Në mungesë të një kornize të tillë ligjore, me këtë raport bëhet vlerësimi i njësisë shpenzim në një mënyrë hipotetike, me një sy shikojmë se çka aty, e me syrin tjetër shikojmë se çka nevojitet aty.

## Rrogat e arsimtarëve

Komponenti kryesor i shumicës së programeve arsimore është rroga e arsimtarit. Në Maqedoni rrogat e arsimtarëve në këtë nivel janë relativisht fikse – 10.500 denarë në muaj ose 126.000 denarë në vit. Ekziston një rritje e caktuar në nivel vjetor – gjegjësisht sa më i lartë është stazhi, aq më lartë është rroga – por rritja e tillë është kufizuar në 0.5% në vit. Kjo është shumë që nuk e merr arsimtari, por që paguhet nga punëdhënësit. Në fund, një shumë të caktuar parash mbahet nga shteti për Fondin e Sigurimit Social: 60% nga shuma e përgjithshme prej 126.000 denarë në vit. Kur e llogarisim bashkë, arrijmë në shumën e përgjithshme të mjeteve për rrogën e arsimtarit gjatë një vitit, përkatësisht 215.460 denarë.

## Trajnimi dhe mbikëqyrja

Nëse gjatë viteve të ardhshme vërejmë zgjerim të shpejtë të programeve për ZHHF, sfida e vërtetë do të jetë sigurimi i trajnimit cilësor për një numër të mjaftueshëm të arsimtarëve. Nëse të gjithë arsimtarët duhet të kalojnë nëpër studime të gjata akademike, kjo mund të paraqesë vështirësi në procesin e zgjerimit. Problem tjetër është ajo se në rajonet ku përfaqësimi i programeve për ZHHF është më i vogël, ka disa persona të rritur që kanë kualifikime që të regjistrohen edhe në studime akademike. Arsimtarët e rinj do të duhet të vijnë nga vende të tjera dhe kjo zakonisht paraqet problem, siç dëshmojnë për këtë përvojat e zgjerimit nga vende të tjera në botë. Shpeshherë është vështirë të angazhohen arsimtarë nga vende të tjera dhe, nëse ata vijnë nga ndonjë vend tjetër, ballafaqohen me vështirësi për t'u përshtatur me rrethanat lokale. Si pasojë e kësaj, ekziston një trend drejt angazhimit të edukatorëve lokale që janë mjaft të motivuar, por të cilët sigurisht nuk janë aq të përgatitur nga perspektiva akademike. Këta arsimtarë duket se mund të gjenden mirë me kusht që të marrin trajnime të shpeshta për freskimin

e diturive dhe përmes zbatimit të mbikëqyrjes së shpeshtë (van Ravens, 2008b, 2009, 2010a, 2010c). Përvojat e vendeve të tjera tregojnë se shpenzimet e trajnimit dhe mbikëqyrjes janë deri në 15% nga shpenzimet e rrogave, që në rastin e Maqedonisë do të ishte 32.319 denarë në vit.

## Shpenzimet operative

Është shumë e qartë se shpenzimet për shërbime komunale varen nga hapësira. Sa është madhësia e sipërfaqes? A ka izolim të mirë gjatë të ftohtit të dimrit. Megjithatë shumica e qendrave për ZHF janë shumë më të vogla se KF-të formale dhe zakonisht te ato mund të pranohet grup prej 20 fëmijëve ose 10% deri në 15%. Shpenzimi për energji elektrike dhe ngrohje për një hapësirë gjatë një viti është 40.000 denarë. Shpenzimet për ujë në një vit arrijnë 10.000 denarë. Paratë që shpenzohen për pastrim, mirëmbajtje dhe përmirësime më të vogla arrijnë deri në 20.000 denarë në një vit. Prandaj shuma që paguhet për shërbime komunale gjatë një viti arrin në 70.000 denarë.

## Shpenzimet materiale

Për një qendër për ZHHF këto shpenzime i referohen materialit të zyrës: materialeve për mësim, përfshirë edhe librat dhe posterët; lodrave dhe inventarit. Edhe pse materiali sigurohet rregullisht, materialet e tjera nuk blihen me atë dinamikë. Një qasje e përgjithshme është që të bëhet një analizë e shpenzimit të këtyre në nivel vjetor. Kjo do të thotë se çmimi ndahet me numrin e viteve për të cilat ato mund të përdoren para se të ketë nevojë të ndërrohen, që ashtu të përcaktohet shpenzimi për një vit. 40.000 denarë në vit shpenzohen zakonisht për lodra dhe materiale për mësim. Për inventarin që ka qëndrueshmëri më të gjatë – siç janë karriget dhe tavolinat – UNICEF-i ka përgatitur një komplet standard për 20 fëmijë dhe 12 prindër. Kjo kushton rreth 2.190<sup>10</sup> dollarë amerikanë. Cikli jetësor i këtij inventari mund të thuhet se është 10 vjet (Carter et al, 2008; van Ravens, 2010c), që do të thotë se në plan afatgjatë 219 dollarë amerikane ose 11.000 denarë në vit duhet të mbahen anash për ndërrim gradual të inventarit me kalimin e viteve. Pa sigurimin e rezervave të tilla nuk mund të flasim për financim të qëndrueshëm. Kuptohet se politika e këtyre e ruajtjes së rezervave nuk e zgjidh problemin për financimin paraprak të investimeve fillestare; por, në këtë çështje do të kthehemi më poshtë. Të dalat e përgjithshme vjetor për shpenzimet materiale arrijnë deri në 51.000 denarë.

---

10 Çmimi zyrtar për një komplet të tillë është 3.290 dollarë amerikanë, por paketa po ashtu përfshin lodra, materiale didaktike, ilustrime dhe materiale për të vizatuar. Ajo shumë tashmë është përfshirë në shumën prej 40.000 dollarë në nivel vjetor për ndërrimin e inventarit. Që të shmanget llogaritja e dyfishtë, atë do të heqim nga paketa e UNICEF-it.

## Nuk është përfshirë: ushqimi, përbërësit ushqimorë, materialet medicinale, transporti

Disa nga komponentët që shpeshherë inkuadrohen në shpenzimet për ZHHF nuk janë përfshirë këtu. Argumenti me të cilin shpjegohet se pse nuk është përfshirë edhe ushqimi në shpenzime është se numri i orëve gjatë një dite është mjaft i vogël që të pritet se fëmijët do të jenë të pranishëm ndërmjet ushqimeve: mes mëngjesit dhe drekës ose mes drekës dhe darkës. Përbërësit ushqimorë dhe materialet medicinale zakonisht janë pjesë e shpenzimeve të qendrave për ZHF, në të cilat janë të integruara mësimi dhe mbrojtja shëndetësore; që nuk është rast me Maqedoninë, ku mbrojtja shëndetësore është e ndarë. Dhe, në fund, shpenzimet për transport nuk janë përfshirë, sepse ato hyjnë në pjesët vijuese, aty ku flitet për implikimet financiare për dendësinë e vogël të popullatës.

## Njësia shpenzim operativ

Nëse mblidhen shpenzimet e arsimit, trajnimit dhe mbikëqyrja, shërbimet komunale dhe shërbimet komunale, siç janë shpenzimet materiale, fitohet shumë prej 369.000 denarë në nivel vjetor. Ato janë *shpenzime operative* të një qendre ose të cilësdo organizatë tjetër që siguron programe gjysmëditore për ZHHF. Supozimi jonë është se në këtë moment shërbimet sigurohen për grup prej 20 fëmijësh. Në praktikë, kjo çdoherë duhet të zvogëlohet për 10% për vende që përkohësisht nuk përdoren: sepse në secilën qendër mund të plotësohet një grup prej 20 fëmijësh. Megjithatë, meqë bëhet fjalë për programe gjysmëditore, gjatë 5 ditëve të javës në hapësirë (klasë) mund të përfshihen 2 grupe të fëmijëve. Për shembull, fëmijët e moshës katërvjeçare mund të shkojnë në qendër në orët e paradites (e pastaj, pas dite, mund të flenë në shtëpi), ndërsa fëmijët e moshës pesëvjeçare të shkojnë në qendër pas dite. Kjo do të thotë se arsimtari punon me fëmijët në dy ndërrime me nga 3 orë çdo ditë, ndërsa 2 orë i mbeten për përgatitje, komunikim me prindërit, komunikim me bashkëpunëtorët në komunë etj. Nga kjo del se kapaciteti i plotë i një klase të pajisur me një arsimtar është të pranojë  $2 \times 18 = 36$  fëmijë. Kjo do të thotë se shpenzimet operative arrijnë në  $369.000 / 38 = 9.711$  denarë (për një fëmijë gjatë një viti).

Ky rezultat mund të kualifikohet ashtu siç është paraqitur në Tabelën 4 të këtij raporti. Në tabelë është treguar se njësia shpenzim për programin gjysmëditor është thuaja katër herë më e vogël se njësia shpenzim për program tërëditor në tre vende të EQL/ Komonueitit të Shteteve të Pavarura që krahasohen. Në shikim të parë rezultatet që janë fituar në Maqedoni nuk janë në pajtueshmëri me këto qasje: njësia shpenzim për programin gjysmëditor prej 9.711 denarë është shtatë herë më e vogël se njësia

shpenzim për program tërëditor prej 71.590 denarë, por nuk është katër herë më e vogël. Megjithatë dallimi i tillë mund të shpjegohet me dy fakte. Së pari në shumën prej 9.711 denarësh nuk janë përfshirë shpenzimet plotësuese operative që ndërlihen me dendësinë e vogël të popullatës; kjo do të përpunohet në pjesën vijuese të këtij kapitulli, e me të do të rritet edhe mesatarja nacionale e shpenzimeve. E dyta, e shprehur si përqindje nga BPV-ja për banor, njësia shpenzim për program tërëditor në Maqedoni është mjaft e lartë 44.4%) në krahasim me njësinë shpenzim në Armeni, Kirgizi, Moldavi dhe Poloni (mesatarisht 19.3%), siç është paraqitur në Skicën 10.

## Investimi fillestar

Përveç shpenzimeve operative, ekzistojnë edhe shpenzime për investimin fillestar. Kjo ishte shqyrtuar më shumë kur ishte përmendur shuma prej 2.190 dollarë amerikanë (110.000 denarë) për vlerën e inventarit. Subjektet që e sigurojnë programin duhet që në nivel vjetor të kursejnë që ashtu të bëhet ndërrimi i inventarit, por me atë edhe të eliminohet problemi se këto para duhet të sigurohen nga fillimi i programit. Bankat zakonisht nuk sigurojnë hua për qendrat për ZHHF, madje edhe nëse ato hua sigurohen, megjithatë problemi rreth pagesës së kamatës mbetet.

Inventari është vetëm pjesë e problemit. Shpenzimet që kanë të bëjnë me vendosjen e gardhit që ashtu të sigurohet mjedis i sigurt për lojë jashtë janë po aq të vëllimshme sa shpenzimet për inventar. Ndërsa instalimi i ngrohjes qendrore mund të jetë edhe më i shtrenjtë. Megjithatë më i shtrenjtë është renovimi i objekteve shpeshherë të dëmtuara që komunat i lënë në disponim të programeve për ZHHF. Këtu mund të bëhet fjalë për shuma deri në miliona denarë, por kjo varet nga gjendja e objektit. Një pjesë e qendrave që ishin iniciuar nga Banka Botërore dhe UNICEF-i mund të hapen përsëri me shpenzime relativisht të vogla, por në raste të tjera shpenzimet do të jenë dukshëm më të mëdha. Fundja edhe shkalla deri ku komunat mund të kontribuojnë në aspekt financiar po ashtu dallohet ndërmjet komunave. Marrë në përgjithësi, komunat synojnë ta shfrytëzojnë përmirësimin e pagesës së tatimeve të vogla; këtu po ashtu mund të ndihmojë edhe rritja e pjesëmarrjes së TVSH-së. Megjithatë mbeten dallimet evidente ndërmjet komunave në raport me zhvillimin ekonomik lokal.

Gjithë kjo e vështirëson krijimin e një vlerësimi të përgjithshëm të shpenzimeve dhe të normave komunale në raport me investimet fillestare. Për ato arsye, investimet fillestare në këtë raport shqyrtohen si një çështje më vete. Kjo do të shikohet rast pas rasti. Në këtë çështje do të kthehemi në kapitullin vijues që i referohet financimit.

## C-dendësia

Faktori i fundit në formulë është koeficienti me të cilin arsyetohen dallimet në raport me dendësinë e popullatës. Që të llogaritet ky koeficient, do të shërbejemi me simulim. Ndërlíkueshmëria e kësaj çështje do të zvogëlohet me atë që do të supozojmë se lënda e financimit të qendrave për ZHF nuk janë 85 komunat në Maqedoni, porse tetë rajonet. Me këtë rast duhet të theksojmë se kjo bëhet me qëllim që gjërat të thjeshtësohen. Ajo që është e rëndësishme këtu është llogaritja e koeficientit të dendësisë së popullimit në nivel *nacional*. Në këtë aspekt ka pak mundësi që rezultati të dallohet nëse kjo bëhet në bazë të numrit të komunave. Në fund, pasi të zbatohet ky plan, kjo do të duhet të përsëritet edhe për komunat, sepse ekzistojnë komuna me dendësi të vogël të popullsisë në rajone me dendësi të madhe dhe anasjelltas.


Ideja themelore është se njësi shpenzim është më e lartë për qendrat për ZHHF që gjenden në rajone me dendësi të vogël të popullsisë. Por, disa rajone kanë dendësi më të vogël të popullsisë se të tjerat. Megjithatë mbete sfidë që të gjendet mekanizëm me të cilin mund të arsyetohet ekzistimi i atyre dallimeve. Njëherazi duhet që ai mekanizëm të jetë i thjeshtë, se qendrat duhet të kenë liri në vendosjen se si do ta përdorin saktësisht financimin plotësues. Disa mund ta përdorin që ta financojnë transportin e fëmijëve, të tjerat mund të shërbehen me kopsht mobil për fëmijë, ashtu që qendra të shkojë te fëmijët. Një pjesë e parave mund të jepen për shpenzimet e transportit të arsimtarëve, një pjesë mund të përdoren që të mbështetet sigurimi i shërbimeve në kushte shtëpiake në lagje të vogla dhe të izoluar. Kjo është e pamundur të organizohet nga pushteti qendror dhe prandaj duhet të sigurohet mënyrë e thjeshtë për financim plotësues për njësi shpenzimi. Në këtë pjesë sigurohet mënyra e përcaktimit të financimit plotësues në raport me dendësinë e popullatës në tetë rajone të Maqedonisë, ndërsa është paraqitur edhe mesatarja nacionale.

Ashtu siç pritej, dendësia më e madhe e popullsisë është në rajonin e kryeqytetit, me një dallim të theksuar në raport me rajonet e tjera. Vlerat e rajonit të Vardarit janë më të vogla. Duke i marrë parasysh këto parametra për gjendjen fillestare, në tabelën 5 është bërë një llogaritje e mjeteve plotësuese për secilin rajon dhe mesataren e vlerësuar për Maqedoninë.

Në kolonën e parë të Tabelës 5 janë paraqitur të dhënat për dendësinë e popullatës siç është treguar në Skicën 13. Meqë dendësia e popullsisë në rajonin e Shkupit është shumë e shprehur, ata që i krijojnë programet për ZHHF për këtë rajon kanë nevojë për financim plotësues zero. Që këtu del se Shkupi shërben si pikë referimi. Prandaj vlerat e kolonës së dytë për dendësinë e popullatës së rajoneve të tjera janë hequr nga vlerat

e Shkupit. Të dhënat e kësaj kolone janë të kundërta me dendësinë, gjegjësisht ato i referohen popullimit të rrallë. Për këtë arsye vlera më e lartë është për rajonin e Vardarit, ndërsa për rajonin e Shkupit është zero.

**Skica 13:** Dendësia e popullatës në Maqedonia sipas rajoneve, 2009



**Burimi:** rajonet në Republikën e Maqedonisë 2009, Shkup, Enti Shtetëror i Statistikës (2010a:79-93)

Të dhënat që gjenden në kolonën “popullimi i rrallë” janë shumëzuar me faktorin (0.086445) i cili është kalibruar ashtu që rezultati për rajonin e Vardarit është 25%. Argument për këtë është se kjo përqindje i prezanton mjetet plotësuese që u nevojiten qendrave për ZHHF në rajonet me popullim të rrallë që t'i mbulojnë shpenzimet që burojnë nga largësia (shpenzimet e rrugës, autobusin e shkollës etj. Në rajonet e tjera kjo përqindje është më e ulët ose diçka më e ulët.

Kur merret si mesatare, ajo shumë plotësuese për Maqedoninë është 19.6%, por ajo përqindje nuk është e vlerësuar (e matur), andaj aty janë vënë kllapa. Që të fitohet mesatarja e vlerësuar, vlerat e kolonës së titulluar “mjetet plotësuese për rajone” shumëzohen me numrin e fëmijëve të moshës 1 deri në 4 vjeç, sepse ata janë fëmijë që do të jenë grupi jonë qëllimor në vitet e ardhshme. Rezultati i fituar i shumëzimit shtohet, pjesëtohet me numrin e përgjithshëm të fëmijëve të moshës nga 1 deri në 4 vjeç në Maqedoni dhe kështu arrihet në mesataren e vlerësuar nacionale: 14.7%. Kjo shumë është më pak se mesatarja e vlerësuar prej 19.6%, sepse është e qartë se relativisht shumë fëmijë jetojnë në popullatë më të dendur, përkatësisht në rajonin e Shkupit dhe të Pollogut.

**Tabela 5:** Llogaritja e mesatares së vlerësuar nacionale nga mjetet plotësuese për dendësinë e popullsisë

	Dendësia e popullsisë	Popullimi i rrallë	Mjetet plotësuese sipas rajoneve	Popullata e moshës 1 - 4	Shuma plotësuese e shumëzuar me popullatën	Mesatarja e vlerësuar
Vardari	38	289	25.0%	6317	157924	
Lindor	51	276	23.9%	6497	155123	
Jugperëndimor	67	261	22.5%	8730	196817	
Juglindor	63	264	22.9%	7335	167649	
Pellagonia	50	277	24.0%	9546	228912	
Pollogu	129	198	17.2%	13858	237674	
Verilindor	75	252	21.8%	7846	170851	
Shkupi	327	0	0.0%	29327	0	
Maqedonia	82		(19.6%)	89456	1314950	14.7%

**Burime:** Dendësia e popullsisë: Rajonet në Republikën e Maqedonisë 2009. Shkup, Enti Shtetëror i Statistikës (2010a:79-93). Të dhënat për popullatën: Vlerësimet për popullatën sipas gjinisë dhe moshës, sipas komunës dhe sipas rajonit statistikor, 2009. Shkup, Enti Shtetëror i Statistikës (2010b: 66-67)

Mesatarja e mjeteve plotësuese në shumë prej 14.7% do të thotë se c-dendësia është 1.147.

## Shpenzimet e përgjithshme

Tash mund të kompletohet formula të cilës i referoheshim në këtë kapitull:

**Gjithsej shpenzime = p \* njësia shpenzim \* c- dendësia**

Kjo do të thotë se:  $34.763 * 9.711 \text{ denarë} * 1.147 = 387.208.266 \text{ denarë}$  për një vit.

Ose përmbledhtas: për 387 milionë denarë në vit Maqedonia mund të sigurojë program gjysmëvjetor për ZHHF për të gjithë fëmijët e moshës 4 dhe 5-vjeçare që nuk shkojnë në KF.



## Qëndrueshmëria financiare

Në këtë kapitull do të ndalemi në mënyrat e mbulimit të shpenzimeve. Së pari do ta shqyrtojmë shumën e përgjithshme të shpenzimeve operative prej 387 milionë denarë në vit, e pastaj edhe shpenzimet për investimin fillestar.

### Mënyra dinamike e kombinimit të financimit

Njëri nga parimet e politikës, që ishte përpunuar në kapitullin 5k ishte se shpenzimet për programet gjysmëditore për ZHHF mund të ndahen ndërmjet pesë burimeve dhe se kombinimi i tillë me kalimin e kohës mund të ndërrohet.

- Qeveria
- Kompensimi i konsumatorëve sipas të ardhurave personale që i realizojnë
- Përfitimeve nga efikasiteti i KF-ve aktuale
- Rritja e kompensimit për programet tërëditore në KF
- Sektori privat dhe donatorët

Me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëri, supozohet se sektori privat do të kontribuojë për investimin fillestar, e jo për shpenzimet operative; kjo do të përpunohet më tej në pjesën e fundit të këtij kapitulli. Në lidhje me katër burimet e tjera të financimit, së pari do të diskutojmë për kompensimin që e paguajnë konsumatorët; pastaj për përfitimet e efikasitetit të KF-ve dhe për kompensimin që paguhet për programet tërëditore në KF. Në fund do të marrim në shqyrtim edhe gjithçka që mbetet nga Qeveria dhe për atë do të jepen skenarë të ndryshëm.

## Kompensimi i konsumatorëve sipas të ardhurave personale që i realizojnë

Për disa qendra për ZHHF që funksionojnë momentalisht, prindërit zakonisht paguajnë kompensim prej 400 denarë për fëmijë në muaj. Në nivel vector kjo shumë arrin në 5.000 denarë. Kjo paraqet një pjesë të rëndësishme të njësisë shpenzim nga 9.711 denarë. Megjithatë shumë prindër nuk mund t'ia lejojnë vetes ta paguajnë këtë kompensim dhe prandaj ata janë të liruar nga pagesa. Po ashtu në disa vende, veçmas në zonat e margjinalizuara, praktikisht asnjë familje nuk e paguan atë kompensim. Kjo do të thotë se absolutisht e rëndësishme është të ekzistojë politikë me të cilën parashikohet mospagesa e kompensimit, e cila do të jetë e vendosur në nivel nacional dhe do të formulohet me ligj. Familjet nuk duhet të pyeten se a duhet të paguajnë apo jo. Për këtë duhet të ekzistojnë kritere të qarta që nuk duhet të dallohen për komuna të ndryshme.


Në kapitullin 4 thamë se ekzistojnë mënyra të ndryshme për elaborimin e asaj politike. Nga shkalla rrëshqitëse ku paguhet në bazë të të ardhurave, deri te shkalla dikotomike që i ka dy opsione: ata që paguajnë dhe ata që nuk paguajnë. Në raport do ta elaborojmë opsionin e fundit.

Ose, më konkretisht, Qeveria siguron transfer vertikal të subvencioneve për komunën për secilin fëmijë të regjistruar dhe ai subvencion për banor do të jetë 400 denarë në muaj më shumë për secilin fëmijë për të cilin është parashikuar të lirohet nga pagesa. Kjo do të thotë se as për qendrat për ZHHF e as për komunën nuk bëhet kurrfarë dallimi kur bëhet fjalë se a është fëmija i varfër apo jo; edhe qendra edhe komuna e fitojnë atë shumë për secilin fëmijë. Kuptohet se çështja që shtrohet këtu është se cili është kriteri sipas të cilit prindërit do të lirohen nga pagesa e kompensimit. Ky patjetër duhet të jetë një kriter i përkufizuar, me të cilin pengohet mundësia për mashtrim.

Në një kontekst pak më ndryshe Verme (2008:8) propozon pjesëmarrje në skemat e ndihmës sociale në para (Ndhma sociale në para – NSP) si kriter për të pasur qasje në një të drejtë të caktuar. Megjithatë këtu shtrohen dy pyetje. Së pari, siç thekson Verme në një vend tjetër (2008:5), gjysma e njerëzve që janë shfrytëzues të ndihmës sociale në para nuk janë të varfër. Këtu mund të shtojmë se e kundërta – gjegjësisht përjashtimi i njerëzve që meritojnë të jenë të inkuadruar – sigurisht do të ndodhë deri në një shkallë. E dyta, numri i njerëzve që marrim ndihmë sociale në para nuk i përgjigjet numrit të njerëzve që janë në kufi të varfërisë. Në tetor të vitit 2007 62.997 familje merrnin ndihmë sociale në para, me çka ishin përfshirë gjithsej 219.063 anëtarë të familjeve (Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, 2008: 25). Kjo është rreth 10% nga popullata e përgjithshme. Harta e Skicës 14 tregon se përqindja më e lartë e shfrytëzuesve (më

shumë se 15%) mund të gjenden në rajone më të pasura, përkatësisht në rajonin e Shkupit dhe të Pollogut. Në rajonet më të largëta pjesëmarrja është nën 7.5%.

**Skica 14:** Shfrytëzuesit e ndihmës sociale të moshës 18-vjeçare e më lart, sipas rajoneve, 2008



**Burimi:** E kopjuar nga rajonet e Republikës së Maqedonisë 2009a, Enti Shtetëror i Statistikës (2010:20)

Megjithatë në Skicën 7 shkalla e varfërisë ishte afër me 30%. Kjo është tre herë më pak se përfshirja e ndihmës sociale në para. Te familjet me fëmijë – që janë grupi jonë qëllimor – shkalla e varfërisë është shumë më e lartë dhe arrin në 48.5%. (Perezniето dhe Uzunov, 2008)<sup>11</sup>. Vërtet kriteret për ndihmë sociale në para (Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, 2008:23) janë të tilla që lejojnë mundësinë e ndërprerjes së ndihmës sociale në para nëse ekziston vetëm edhe një pronë e vogël, që mund të jetë edhe aq e vogël, që personi përsëri të konsiderohet i varfër.

Mënyra më e mirë e ballafaqimit me dallimet ndërmjet përfshirjes me ndihmë sociale dhe shkallës së varfërisë në këtë raport është që të bëhen dy variante: njëra me ndihmë sociale në para si kriteri më i rreptë për ç'arsye shfrytëzuesi lirohet nga pagesa e kompensimit, ndërsa varianti i dytë është jetesa në kufirin e varfërisë si kriter më i rreptë (kriteri i dytë është më vështirë që të zbatohet).

Që të llogaritet përqindja e fëmijëve që do të lirohen nga pagesa e kompensimit, do ta pohojmë këtë për variantin e dytë – për ndihmën sociale në para kriter është:

<sup>11</sup> Ose më saktë: shkalla e varfërisë u rrit nga 49.3% në vitin 2002 në 66.6% në vitin 2005, e pastaj shënoi rënie në 48.5% në vitin 2007. Shkalla e varfërisë për familjet me fëmijë ishte 29.4% në vitin 2007. (Perezniето dhe Uzunov, 2008).

- Numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para si pjesë e popullatës së përgjithshme: 10%
- Pjesëmarrja e fëmijëve 4 dhe 5-vjeçarë që janë regjistruar në KF: 23%
- Numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para me fëmijë në KF: i parëndësishëm
- Ndarja e zakonshme është si në tabelën 6:

**Tabela 6:** Ndarja për 100 fëmijë sipas KF-vë dhe ndihmës sociale në para

	Në KF	Nuk janë në KF	Gjithsej
Me ndihmë sociale në para	0	10	10
Pa ndihmë sociale në para	23	67	90
Gjithsej	23	77	100

Që këtu del se nga 100 fëmijë 77 nuk janë në KF dhe duhet të inkuadrohet në program gjysmëditor. Prej këtyre 77 fëmijëve 10 janë në skemën e ndihmës sociale në para. Ata janë 13% nga grupi jonë qëllimor. Kështu mund ta rumbullakojmë shifrën 15%, sepse familjet e varfra mesatarisht kanë më shumë fëmijë.

Për fëmijët që jetojnë në kufi të varfërisë argumentet janë të ngjashme:

- Nën kufirin e varfërisë: 48% nga të gjitha familjet me fëmijë
- Numri i fëmijëve që jetojnë nën kufirin e varfërisë, por të cilët janë regjistruar në KF është shumë i vogël, por jo edhe i pakonsiderueshëm në bazë të të dhënave për numrin e fëmijëve të regjistruar në KF
- Ndarja e zakonshme është si në tabelën 6:

**Tabela 7:** Ndarja për 100 fëmijë sipas KF-ve dhe kufirit të varfërisë

	Në KF	Nuk është në KF	Gjithsej
Nën kufirin e varfërisë	2	46	48
Mbi kufirin e varfërisë	21	31	52
Gjithsej	23	77	100

Nga kjo del se 46 nga 77 fëmijë që janë në grupin tonë qëllimor janë nën kufirin e varfërisë. Kjo është 60%. Në këtë rast nuk është mirë ta rumbullakojmë numrin e tyre, për shkak të numrit të madh të fëmijëve të familjeve të varfra, sepse ajo tashmë nënkuptohet me zbatimin e shkallës së varfërisë për familjet e fëmijëve.

Mundësia e tretë kuptohet është të mos paguhet kurrfarë kompensimi. Kjo është logjike në aspekt të asaj se nuk është e qartë se pse duhet të paguhet kompensim për programet për ZHHF nëse niveli fillor dhe nivelet më të larta të arsimit janë falas.

Në Tabelën 8 është paraqitur llogaritja e të ardhurave të përgjithshme vjetore nga kompensimi që e paguajnë konsumatorët sipas varianteve – e lartë (15% të liruar), mesatare (60% të liruar) dhe e ulët (falas për të gjithë). Pastaj përqindja e fëmijëve për të cilët paguhet kompensim shumëzohet me grupin e përgjithshëm qëllimor, e pastaj numri absolut i paguesve shumëzohet me numrin 12 për kompensimin mujor nga 400 denarë.

**Tabela 8:** Llogaritja e të ardhurave vjetore nga kompensimi që e paguajnë konsumatorët sipas variantit të lartë, të mesme dhe të ulët.

Varianti	Të liruar nga pagesa	Kompensim i paguar	Grup qëllimor	Konsumatorë që paguajnë kompensim	Të ardhurat
E lartë	15%	85%	34763	29549	<b>142 mil. den.</b>
E mesme	60%	40%	34763	13905	<b>67 mil. den.</b>
E ulët	100%	0%	34763	0	<b>0</b>

## Dobitë nga efikasiteti i punës në KF-të aktuale

Burimi i dytë i financimit është përfitimi nga efikasiteti i funksionimit të KF-ve formale. Në Skicën 10 është treguar se shpenzimi për KF-të në Maqedoni arrin në 44.4% nga Bruto Prodhimi Vendor, përballë mesatares prej 19.3% të Bruto Prodhimit Vendor në vendet e tjera të EQL/Komonueltit të Shteteve të Pavarura. Pastaj mund të formulohen disa qëllime të mundshme. E para është që plotësisht të tejkalohet dallimi dhe ato 44.4% të bien në 19.3%. Ndonëse nuk ka arsye pse mos të realizohet, megjithatë ky është një qëllim ambicioz. Më reale është mundësia që ky dallim të zvogëlohet për gjysmë dhe shpenzimet për KF të bien në 31.9% nga Bruto Prodhimi Vendor. Nga kjo bëhet e qartë se kjo patjetër duhet të bëhet përmes një procesi afatgjatë, por edhe për zgjerimin e programeve gjysmëditore do të nevojitet mjaft kohë. Qëllim tjetër mund të jetë arritja e nivelit të vlerës së dytë më të lartë – nivelit të Moldavisë. Megjithatë vlera e në Moldavi duket se është mjaft afër qëllimit të parë prej 31.9%, andaj ky opsion nuk do të shqyrtohet. Në fund mund të shqyrtohet edhe mundësia për përgjysmimin e këtij dallimi nga vlera në Moldavi. Kjo do të rezultonte në qëllimin më pak ambicioz prej 38.2%. Në Tabelën 9 është paraqitur llogaria e përfitimeve nga efikasiteti, përsëri për variablen më të lartë dhe më të ulët. Të dyja qëllimet e shpenzimet (31.9 dhe 38.2 % për bruto prodhimin vendor për banor) shumëzohen me buxhetin dhe rezultati pjesëtohet me shpenzimin aktual (44% nga bruto prodhimi vendor për banor). Ky është buxheti i ri i cili merret nga buxheti i vjetër dhe kështu fitohet shuma e përfitimeve nga efikasiteti i punës.

**Tabela 9:** Llogaria e përfitimeve nga efikasiteti në KF sipas variablës së lartë dhe të ulët

Variabla	Qëllimi i pritur	Buxheti	Faktori	Buxheti i ri	Përfitimet nga efikasiteti
E lartë	31.9% BPV	1,100 mil.	31.9/44.4	790 mil.	<b>310 mil. den.</b>
E ulët	38.2% BPV	1,100 mil.	38.2/44.4	946 mil.	<b>155 mil. den.</b>

**Burimi:** për këtë buxhet: shih fusnotën 4 të këtij raporti.

## Rritja e kompensimit për programet tërëditore në KF

Deri tash numri më i madh i fëmijëve që ishin regjistruar në KF-të formale ndjekin programe tërëditore. Për këtë prindërit paguajnë kompensim prej 1.490 denarë në muaj. Si kompensim, ata fitojnë shërbim në vlerë prej rreth 6.000 denarë për një muaj. Që këtu pjesa e subvencionuar arrin në 4.500 denarë për një muaj ose 55.000 denarë në vit. Me këtë zvogëlohet njësia shpenzim për programin gjysmëditor prej 9.711 denarë, prej çka do të kenë dobi familjet më të varfra nëse ato nuk paguajnë kurrfarë kompensimi. Nëse ato do të paguanin kompensim prej 440 denarësh në muaj, atëherë do të përgjysmohej shuma prej 9.711 denarë, me çka edhe më i shprehur do të ishte dallimi me klientët e privilegjuar të KF-ve. Këta të fundit do të përfitonin *dhjetë herë më shumë* nga shteti se familjet që i përdorin programet gjysmëditore dhe paguajnë kompensim për atë. Kjo nuk është *fer-lojë*.

Prandaj do të jetë modeste nëse themi se do të ishte e arsyeshme të rritet kompensimi për KF-të formale që ashtu të ndihmohet financimi i programeve gjysmëditore për ZHHF të cilat propozohen me këtë raport. Me variablën më të ulët kompensimi do të rritej për 550 denarë në muaj deri në 2.000 gjithsej për programin tërëditor. Me variablën më të lartë kompensimi do të rritej për 1.000 denarë në muaj, me çka do të fitohen 12.000 për një vit. Në Tabelën 10 është dhënë llogaritje e përfitimeve nga këto dy variabla.

**Tabela 10:** Llogaria e përfitimit që buron nga rritja e kompensimit sipas variablës së ulët dhe të lartë

Variabla	Kompensimi i rritur	Fëmijët e regjistruar	Përfitimet
E lartë	12,000 denarë	17607	<b>106 mil. den.</b>
E ulët	6,000 denarë	17607	<b>106 mil. den.</b>

## Çka mbetet të paguhet nga Qeveria?

Që të hiqet shuma e “mjeteve të reja financiare” (për dallim nga efikasiteti dhe të ardhurat plotësuese nga kompensimi), që duhet të sigurohen nga Qeveria, në Tabelën 11 janë paraqitur 12 kombinime të mundshme që mund të burojnë nga variabla e lartë, e mesme dhe e ulët.

Skenari numër 1 është ajo që do të përfitohet nëse vendosim për variablën më të lartë për të gjitha tre burimet e financimit nga kombinimi i financimit. Kështu realizohen 142 milionë denarë nga kompensimi që e paguajnë konsumatorët për programet gjysmëditore; plus 310 milionë denarë nga përfitimet më ambicioze nga efikasiteti i KF-ve; plus 211 milionë denarë nga rritja e kompensimit mujor për programet tërëditore për 1.000 denarë. Shuma e përgjithshme është 663 milionë denarë. Skenari 12 është bërë nga variablat me të ulëta: mospagesa e kompensimit për programet gjysmëditore, përfitimi modest nga efikasiteti i KF-ve dhe rritja modeste e kompensimit për programet tërëditore. Shuma e përgjithshme këtu është 261 milionë denarë. Skenarët 2-11 i paraqesin të gjitha kombinimet e mundshme.

Për të gjithë skenarët shuma e përgjithshme hiqet nga shpenzimet e nevojave të përgjithshme që në të gjitha rastet arrijnë në 387 milionë denarë. Rezultati përfundimtar janë mjetet që duhet t'i sigurojë Qeveria.

Nga tabela 11 mund të shihet se në shumicën e skenarëve rezultati i Qeverisë është negativ, që do të thotë se tre burimet e tjera realizojnë më shumë mjete se që është e nevojshme. Rezultati është pozitiv vetëm në skenarët 8, 11 dhe 12, ndërsa në skenarët 4 dhe 10 rezultatet janë negative, por afër kufirit të përfitimit.

Nuk është për t'u befasuar që çmimi më i lartë që duhet të paguhet është për skenarin 12: 126 milionë denarë në vit. Ato janë “para të reja” që duhet t'i sigurojë Qeveria. Të ardhurat nga përfitimi i efikasitetit të KF-ve po ashtu do të shkojë përmes kanaleve të Qeverisë, por këto janë para që tashmë ekzistojnë, tashmë janë në buxhet; ato thjesht do të shpërndahen në mënyrë graduale. Tash do ta shqyrtojmë mundësinë e realizimit të gjenerimit të shumës strukturore prej 126 milionë denarë në vit.

**Tabela 11:** Skenari për ndarjen e shpenzimeve

Sken.	Kompensimi nga konsumatorët	Efikasiteti	Kompensimi për KF	Gjithsej	E nevojshme	Qeveria
1	142	310	211	663	387	-276
2	142	310	106	558	387	-171
3	142	155	211	508	387	-121
4	142	155	106	403	387	-16
5	67	310	211	588	387	-201
6	67	310	106	483	387	-96
7	67	155	211	433	387	-46
8	67	155	106	328	387	59
9	0	310	211	521	387	-134
10	0	310	106	416	387	-29
11	0	155	211	366	387	21
12	0	155	106	261	387	126

## Analiza e mundësisë së realizimit për kontributin më të dobët nga Qeveria

Para se të shqyrtohet zhvillimi i përgjithshëm i buxhetit të Qeverisë, nevojitet të shqyrtohen dy çështje konkrete.

E para ka të bëjë me ndryshimin e moshës në të cilën fëmijët regjistrohen në shkollë fillore nga shtatë në gjashtë vjeç. Si rezultat i kësaj numri i fëmijëve të arsimit parashkollor ka shënuar rënie nga 37.995 në vitin 2006 në 17.607 në vitin 2007 (shih Tabelën 1). Ky është një dallim prej më shumë se 20.000 fëmijë. Një pjesë e tyre kanë qenë në mësim përgatitor shkollor, por po ashtu ka edhe disa mijëra fëmijë që tash shkojnë në shkollë fillore, ndërsa do të kishin mundur të shkojnë në program tërëditor për ZHHF. Njësia shpenzim te këta të fundit është rreth tre herë më e lartë sesa te të tjerët (van Ravens, 2010c). Nëse rreth 5.000 fëmijë “transferohen” nga KF-të në shkolla fillore, përfitimi do të ishte sipas radhitjes së madhësisë prej 240 milionë denarë në aspekt strukturor<sup>12</sup>. Në

12 Ja vlerësimi. Qëndrimi tërëditor në kopsht për një fëmijë kushton 6.000 denarë në muaj. Nëse ky fëmijë do të shkonte në shkollë fillore, shpenzimet për të do të ishin vetëm 2.000 denarë në muaj. Dallimi është 4.000 denarë. Tabela 1 flet se rreth 5.000 fëmijë të moshës 6-vjeçare më parë kanë qenë në kopshte. 4.000 denarë \* 5.000 denarë \* 12 muaj = 240 milionë denarë.

studimin për pasqyrën e shpenzimeve të fokusuar te fëmija, Pereznioto dhe Uzunov (2008) pyesin se ku janë tash ato para. Një pjesë e tyre është e mundur të përdoren për mbulimin e një pjese të shpenzimeve plotësuese për arsimin fillore për grupet që më parë janë lënë jashtë ose kanë ndjekur formë të shkurtër. Këto para do të mund të përdoren për programe gjysmëditore dhe të mbulojnë një pjesë prej 126 milionë denarë e nevojshme në skenarin 12.

Çështja e dytë ka të bëjë me dobitë individuale, sociale dhe ekonomike nga programet për ZHHF. Korpusi i gjerë i studimeve dëshmojnë se cilado shumë e parave të investuar për ZHHF sjellin përfitim që është katër deri në shtatë herë më i madh se investimi fillestar (Heckman, 2006). Përfitimi do të jetë edhe më i madh për programe që janë të dedikuara për grupet e marginalizuara. Kundërgargument i kësaj është se, pavarësisht nga madhësia e përfitimit, megjithatë nevojitet një investim fillestar. Për shembull, programet për ZHHF shpijnë drejt një shëndeti më të mirë dhe përfitimi më të lartë më vonë në jetë, por ekziston edhe një dallim në dekada ndërmjet momentit të investimit dhe momentit të përfitimit nga ai investim. Përveç kësaj, përfitimi i tillë mund të jetë për të mirën e të tjerëve, e jo të atyre që e kanë bërë investimin. Ekonomistët këtë do ta quanin mossakses të tregut.


Megjithatë duket se ndonjë përfitim kthehet shumë shpejt dhe atë në kuadër të fushës në të cilën Qeveria investon. Zvogëlimi i numrit të fëmijëve që e braktisin arsimi dhe të arriturat e mëdha nga mësimi arrihen vetëm disa vite pas fëmijërisë së hershme. Kjo vlen edhe për shpenzimin e kujdesshëm për ndërhyrje të shtrenjta edhe për zvogëlimin e shpenzimit për ndërhyrje të shtrenjta mjekësore gjatë fëmijërisë, kjo si rezultat i mbrojtjes së përmirësuar preventive shëndetësore. Përfundimisht rroga e arsimitarit – komponenti më i madh shpenzimeve – ka ndikim momental i cili shpesh harrohet. Nëse hapen “vende pune për ZHHF” në mjedis ku shumë pak njerëz kanë rrogë të rregullt, kjo do të ketë efekte të drejtpërdrejta dhe të shumëfishta në bashkësinë vendore (van Ravens, 2010b), si dhe për shtetin (Verme, 2008). Për shembull, nëse një person punësohet me rrogë prej vetëm 6.000 denarësh në muaj, kjo do të thotë 55.841 denarë kursim në nivel vjetor për ndihmë sociale dhe sigurim shëndetësor, si dhe përfitim për shtetin në formë të të ardhurave nga tatimi dhe kontributet e sigurimit (Verme, 2008:8).

Duke pasur parasysh këtë, tash do t'i shqyrtojmë mënyrat e realizimit të 126 denarëve, duke e ditur se bëhet fjalë për investim, e jo për shpenzim publik.

## Zhvillimi i buxheteve relevante

Financimi i një shërbimi të ri publik është më i lehtë nëse mbulohet nga rritja e buxhetit, në vend se të bëhet nga buxheti i gjendjes aktuale. Nëse shërbimi i ri është me çmimin e shërbimeve aktuale, siç janë shkollat, universitetet, spitalet, ndihma sociale, atëherë sigurisht do të paraqitet rezistencë e fuqishme, si nga konsumatorët, ashtu edhe nga ofruesit e shërbimeve. Mundësia e rezistencës së tillë është më e vogël – edhe pse nuk mund të shmanget plotësisht – nëse shërbimi i ri buron nga rritja e buxhetit. Që të shqyrtohet shkalla e rritjes së buxhetit, së pari duhet të shqyrtohet Skica 15, ku është paraqitur zhvillimi i buxheteve për mbrojtje sociale, arsim dhe shëndetësi. Shpjegimi për këtë se pse janë zgjedhur pikërisht këto tre fusha është i thjeshtë – ato në mënyrë të natyrshme janë fusha që i referohen zhvillimit të hershëm të fëmijës. Të tria buxhetet shërbejnë thjesht si pika referuese, por kështu nuk bëhet e qartë se cili buxhet duhet të përdoret që të financohen programet gjysmëditore.

**Skica 15:** Buxhetet e mbrojtjes sociale, arsimit dhe shëndetësisë, 2003-2010, në miliarda denarë



**Burimet:** për vitet 2007-2010: të dhënat e Qeverisë; për vitet 2003-2006: Pereznioto dhe Uzunov (2008)

Në Skicën 15 kryesisht është treguar se të tria buxhetet janë rritur gjatë viteve të fundit, përveç disa rënieve të vogla dhe të parëndësishme. Secili nga këto buxhete sot sillet deri në 20 miliardë denarë, ndërsa shuma e përgjithshme ishte 64 miliardë në vitin 2010.

Çështja tjetër që shrohet këtu është se sa është përfshirja e rritjes së buxhetit? Në esencë buxhetet mund të rriten në dy mënyra: si përqindje e BPV-së dhe si rezultat i rritjes së BPV-së.

Të shprehur me përqindje nga BPV-ja të tria buxhetet lëvizin mes 5.5% dhe 6% (Perezniето dhe Uzunov, 2008). Detyrimi i Qeverisë që ta rrisë buxhetin për arsim në 6% është ose përafërsisht ose tashmë është arritur. Kjo do të thotë se kufiri i rritjes së buxhetit në raport me BPV-në është i kufizuar.


Megjithatë, edhe sikur buxhetet janë konstantë që varet nga BPV-ja, ato përsëri mund të rriten në kuptim absolut. Kjo varet nga zhvillimi ekonomik. Në Maqedoni shkalla e rritjes vjetore ekonomike është prej 4% deri në 5% në vitin 1999, me ndërprerje vetëm në vitin 2001-2003 për shkak të situatës së veçantë gjatë këtyre viteve. Ndikimi i krizës globale botërore kuptohet se do të jetë i paparashikueshëm gjatë viteve që vijojnë. Por, me këtë rast duhet të kihet parasysh se nevoja për resurse për programet gjysmëditore është aq e kufizuar, sa që edhe një rritje e vogël e BPV-së do të jetë e mjaftueshme që të mbulohen ato nevoja. Për shembull: nëse BPV-ja rritet për vetëm një përqindje dhe nëse të tria buxhetet mbeten konstante në raport me pjesën e tyre në BPV, hapësira plotësuese fiskale do të jetë 460 milionë denarë. Kjo është pesë herë më shumë se nevoja për resurse prej 127 milionë denarë në skenarin 12. 640 milionë denarët do t'i kalojnë ndjeshëm edhe shpenzimet e përgjithshme për politikën që tash janë 387 milionë denarë. Kështu që edhe nëse nuk paguhet kompensim për program gjysmëditor, nëse KF-të nuk realizojnë përfitim nga efikasiteti i tyre dhe nëse nuk rritet kompensimi që paguhet për KF, rritja ekonomike prej 1% megjithatë do të jetë e mjaftueshme.

Me këtë rast duhet të kihet parasysh se zhvillimi ekonomik është kumulativ, ndërsa nevoja për resurse nuk është e tillë. Ose, me fjalë të tjera, nëse rritja ekonomike është 1% gjatë pesë viteve të ardhshme, rezultati përfundimtar do të jetë rritja prej (më shumë se) 5%, që me një llogaritje të përgjithshme i bie në hapësirë plotësuese fiskale prej më shumë se 3 miliardë denarë. Përkundrazi, nevoja për resurse në shumën 127 milionë denarë është strukturore, por jokumulative. Duke e pasur parasysh demografinë stabile, ajo do të mbetet me dinamikën e njëjtë edhe në vitet e ardhshme.

Një faktor që mund të ndërmjetësojë në rritjen e hapësirës fiskale – qoftë për të mirë ose për të keq – është gjendja e përgjithshme e sistemit financiar. Për shembull, vendet mund të kenë sistem më pak të mjaftueshëm për pagesën e tatimeve, që shpie drejt pagesës së zvogëluar dhe buxheteve të kufizuara edhe kur ka zhvillim të fuqishëm ekonomik. Megjithatë kjo nuk është rast me Maqedoninë. Perezniето dhe Uzunov (2008) theksojnë “pagesë më të madhe të të ardhurave fiskale për shkak të reformave që dukshëm i tejkalon nivelet e projektuara në fillim dhe mundëson konsumim pa ndikuar në baraspeshën e përgjithshme fiskale” (Kapitulli 4.3).

Në fund duhet të përgjigjemi edhe në pyetjen se a ekzistojnë trendë që mund të shpijnë në kërkesa konkurruese nga buxheti shtetëror. Profili demografik në Skicën 16 mund të ndihmojë që të bëhet një vlerësim i tillë.

**Skica 16:** Popullata e Maqedonisë sipas gjinisë dhe grupmoshave gjatë pesë viteve, 30 qershor 2009



**Burimi:** e marrë nga vlerësimet e bëra për popullatën sipas gjinisë dhe moshës, për komuna dhe rajone statistikore, 2009, Shkup, Enti Shtetëror i Statistikës (2010b:11)

**Shënim:** meshkujt janë paraqitur në anën e majtë, ndërsa femrat në anën e djathtë. Në boshtin vertikal janë grupet e të rriturve gjatë pesë viteve, ndërsa në boshtin horizontal është paraqitur numri i meshkujve dhe femrave në mijë.

Profili demografik flet qartë se ka rënie të natalitetit, që nuk ndikon vetëm në kërkesat për programe për ZHHF, por edhe në format e tjera të arsimit. Grupmoshat e mëdha që janë lindur para vitit 1990 lëvizin për të dalë jashtë sistemit arsimor dhe lirojnë vend për hapësirë dhe resurse të të gjitha niveleve. Kuptohet se duhet të kihet parasysh se vijojnë sfida të tjera në raport me cilësinë e arsimit dhe po ashtu shfaqet nevoja për rritjen e shkallës së përfshirjes/regjistrimit në nivelet më të larta. Gjithë kjo kushton para. Por, ka pak mundësi që të thithet gjithë hapësira fiskale që është krijuar me zvogëlimin e numrit të nxënësve.

Implikim tjetër është se hapësira fizike dhe resurset humane bëhen më të kapshme, sepse zvogëlohet numri i nxënësve në shkolla fillore, edhe pse kjo nuk do të jetë njësoj në të gjitha rajonet. Shfrytëzimi i klasave të shkollës fillore dhe rikualifikimi i arsimtarëve

të shkollave fillore që të bëhen arsimtarë për ZHHF është opsjon mjaft serioz. Në atë mënyrë mund të pengohet që shumë arsimtarë të mbeten pa punë dhe ashtu të zvogëlohet shpenzimi për kontributet që jepen për personat e papunë.

Profili ekonomik po ashtu parashikon edhe rritjen e numrit të personave të pensionuar në vitet e ardhshme. Dallimi ndërmjet grupmoshës 55-59 vjeç dhe grupmoshës 60-64 vjeç është mjaft i madh, veçanërisht të meshkujt. Kjo është një sfidë e re për financat shtetërore në Maqedoni prej tash për pesë vitet e ardhshme. Ose, me fjalë të tjera: pesë vitet e ardhshme që janë para nesh, në aspekt të përfshirjes së secilit fëmijë, paraqesin dritare unike të mundësive për zgjerimin e programeve për ZHHF.

## Investimi fillestar

Pjesa e fundit të këtij raporti i referohet hapësirës fizike (objekteve, klasave, hapësirës për zyra) dhe inventarit të nevojshëm për realizimin e programeve gjysmëditore. Kjo në esencë dallohet nga shpenzimet operative që ishin shqyrtuar në pjesët paraprake të këtij kapitulli. Shpenzimet e tilla operative duhet të mbulohen plotësisht nga kontributet strukturore, para së gjithash nga burimet e brendshme: kontribute nga Qeveria në nivele të ndryshme në bazë të tatimit strukturor dhe kompensimit që e paguajnë konsumatorët. Në të kundërtën, nëse financimi i shpenzimeve operative varet (pjesërisht) nga kontributi i donatorëve të huaj dhe kompanive private, sigurimi i këtij shërbimi do të rrezikohet nëse ndërpritet sigurimi i këtij kontributi.

**Tabela 12:** Investimet kapitale në arsim në Maqedoni, 2010, 2011, dhe më tej (në milionë euro)

	2010	2011	Покоа
Arsimi i lartë	5.71	5.74	-
Arsimi fillor dhe i mesëm:	-	-	-
- Konviktet e studentëve	0.10	0.10	-
- Pajisjet për shkollat	3.59	3.59	-
- Modernizimi i sektorit	0.71	-	-
- Gjymnazet	7.90	2.50	52.40
- Renovimi i shkollave të mesme	3.51	3.51	-
- Ndërtimi i shkollave fillore	8.37	8.37	-
Gjithsej	29.89	23.81	52.40

**Burimi:** Programi për investime publike i Republikës së Maqedonisë, 2009-2011 (Qeveria e Republikës së Maqedonisë, 2009)9

Por, kjo nuk vlen edhe për investimin fillestar. Nëse një donator i huaj ose një kompani private e sponsorizon renovimin/ndërtimin dhe pajimin e një numri të qendrave për

ZHHF dhe pastaj tërhiqen, infrastruktura fizike do të mbetet. Shërbimet do të mund të sigurohen derisa shpenzimet për mirëmbajtje dhe këmbim janë të përfshira në njësinë shpenzime të shpenzimeve operative. Ndërsa këtë e kemi bërë.

Që këtu del se në aspekt financiar është arsyeshme të kërkohet kontribut financiar dhe kontribute në të mira materiale nga donatorë të huaj dhe kompani private kur bëhet fjalë për investim fillestar. Në një vlerësim të përgjithshëm të kësaj sfide financiare së pari duhet ta shikojmë Tabelën 12 në të cilën janë prezantuar investimet kapitale në arsim për vitet 2010 dhe 2011.

Në tabelë tregohet se investimet në arsim lëvizin nga 24-30 milionë euro ose rreth 1.5 deri në 2 miliardë denarë në vit. Komponentët më të rëndësishëm të buxhetit janë ndërtimi i shkollave fillore dhe – vetëm për vitin 2010 – gjimnazet. Duke e pasur parasysh gjendjen demografike, mund të pritet se këta dy komponentë do të zvogëlohen dhe kjo mund të vlejë edhe “për pajisjet e shkollave” dhe “renovimin e shkollave të mesme”. Prandaj do të duhet të krijohet mundësi për sigurimin e një sasive të konsiderueshme të parave për qendrat për ZHHF. Kontributet e tjera qeveritare mund të jepen nga komunat që do të ofrojnë hapësirë që mund të rinovohet dhe të pajiset. Kjo pjesërisht mund t’u referohet atyre qendrave për ZHHF të cilat ishin themeluar në vitin 2001 dhe të cilat përsëri mund të vihen në funksion, e pjesërisht mund t’u referohet edhe hapësirave të reja. Ky raport nuk mund të jetë më konkret në raport me nevojat për resurse, sepse së pari duhet të bëhet një vlerësim në nivel të secilës komunë.

Pasi të bëhen ato vlerësim, ekziston mundësi të kontaktohen donatorët e huaj (BE-ja me programet e ndryshme, Banka Botërore, donatorët e ndryshëm bilateralë) dhe kompanitë private të vendit dhe ndërkombëtare me kërkesa dhe propozime që ata ta japin kontributin e tyre. Ne shpresojmë se ky raport do të ndihmojë në krijimin e besimit dhe gatishmërisë të këta partnerë zhvillimorë që të investohet për fëmijët në Maqedoni.

## Rekomandimet

1. Në vitin 2004, me Strategjinë Nacionale për Zhvillimin e Arsimit 2005-2015 dhe ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, ishte theksuar nevoja urgjente për forma alternative në arsimin parashkollor, të cilat do t'i përfshijnë të gjithë fëmijët, pavarësisht prejardhjes së tyre. Maqedonia nuk ia doli që gjatë gjashtë viteve të fundit të veprojë sipas këtyre politikave dhe përcaktimeve ligjore. Kjo ndikon në kredibilitetin e politikës sociale të një shteti. Prandaj jepet rekomandim i fuqishëm që të zhvillohet dhe të zbatohet politikë adekuate sa më shpejt që është e mundur.
2. Më konkretisht, rekomandohet implementimi i programeve gjysmëditore për ZHHF për fëmijët e moshës 4 dhe 5-vjeçare, e pastaj do të vijonte edhe inkuadrimi i fëmijëve të moshës 3-vjeçare kur këtë ta lejojë situata financiare.
3. Edhe pse kopshtet e fëmijëve janë mirë të vendosura që të sigurojnë programe gjysmëditore, do të ketë nevojë edhe për shumë ofrues të rinj të këtyre shërbimeve. Me rëndësi është që institucionet e vjetra dhe të reja të mos jenë të vendosura njëra pranë tjetrës, por të jenë të integruara në një sistem inovativ në të cilin do të ketë këmbim të kompetencave. Prej këtu burojnë edhe rekomandimet e mëposhtme.
4. Programet gjysmëditore duhet të miratohen si shërbim themelor publik, i cili është në disponim të të gjithëve dhe i financuar edhe për të pasurit edhe për të varfrit. Ata që dëshirojnë përkujdesje tërëditore për fëmijët e tyre, do të duhet të paguajnë çmim të caktuar për shërbimet plotësuese.

5. Nevojiten instrumente të reja: qendra për ZHHF, kopshte private për fëmijë, kapacitete që janë të ngritura në kompani ose në kushte shtëpiake. Për këtë qëllim nevojitet një sistem i rreptë i akreditimit. Institucionet që do të akreditohen do ta kenë të drejtën për sigurimin e programeve gjysmëditore dhe për të përfituar subvencione për banor për secilin fëmijë të regjistruar të moshës 4 ose 5-vjeçare.
6. Për shkak të qëndrueshmërisë rekomandohet të kufizohet shfrytëzimi i kontributeve nga donatorët e huaj dhe sponsorët privatë për mbulimin e shpenzimeve fillestare: ndërtimi dhe renovimi; inventari, zhvillimi i programeve; trajnimi fillestar. Shpenzimet operative duhet të mundësojnë mirëmbajtje, këmbim dhe investim në programe dhe njerëz.
7. Shpenzimet operative duhet të mbulohen në mënyrë strukturore përmes kombinimit të burimeve të resurseve. Nga konsumatorët duhet të kërkohet ta paguajnë kompensimin, por ata që nuk mund ta bëjnë këtë, duhet të lirohen nga pagesa e kompensimit. Përfitimet që i realizojnë kopshtet e fëmijëve nga efikasiteti i punës duhet të investohen përsëri në programe gjysmëditore. Po ashtu mund të rritet kompensimi që paguhet për kopshtet e fëmijëve. Qeveria patjetër duhet t'i mbulojë shpenzimet e tjera.
8. Rekomandohet që kjo politikë e propozuar të zbatohet në pesë komuna ku qendrat për ZHHF tashmë ekzistojnë dhe në pesë komuna të tjera që do të zgjidhen në bazë të nevojave dhe gatishmërisë. Nga kopshtet e fëmijëve duhet të kërkohen që ta zhvillojnë rolin e qendrave të resurseve.

# Literatura e shfrytëzuar

- Carter, J., Biersteker, L., and Streak, J., 2008. Costing center-based early childhood development programmes for children under age five: case studies from the western cape. Pretoria, Human Sciences Research Council
- Cyan, M., Martinez-Vazquez, J., and Timofeev, A., 2009. Financing equitable service delivery for all citizens. Skopje, UNDP
- Comenius Foundation for Child Development, 2009. A good start. How to introduce alternative early childhood education services in local communities. Warszawa, Comenius Foundation for Child Development
- Consultative Group on Early Childhood Care and Development, 2008. The Four Cornerstones. To secure a strong foundation for young children. [www.ecdgroup.com](http://www.ecdgroup.com)
- Engle, P., Black, M., Behrman, J., Cabral de Mello, M., Gertler, P., Kapiriri, L., Martorell, R., and Young, M. 2007. Strategies to avoid the loss of developmental potential in more than 200 million children in the developing world. In: *The Lancet*, 369 (9557, 20 January, fq. 229-242
- Evans, J. (Judith), 2006. Parenting Programmes: An important ECD Intervention Strategy. Background Paper for the EFA Global Monitoring Report 2007, Paris, UNESCO
- Evans, J. (John), 2008. Mountain Societies Development Support Programme Kyrgyzstan. Evaluation of the early childhood development program. Bishkek, Aga Khan Foundation

- Grantham-McGregor, S., Cheung, Y., Cueto, S., Glewwe, P., Richter, L., and Strupp, B. 2007. Developmental potential in the first five years for children in developing countries. In: *The Lancet*, 369 (9555), 6 January, fq. 60-70
- Heckman, J., 2006. Skill Formation and the Economics of Investing in Disadvantaged Children. In: *Science*. no. 5782 vol. 312, fq. 1900-1902.
- Irwin, L., Siddiqi, A., and Hertzman, C. 2007. *Early Child Development: A Powerful Equalizer*. Geneva, World Health Organization
- Јанева, Н., 2008. Стратешка евалуација на состојбата со раниот детски развој и предучилишното образование во Република Македонија. УНИЦЕФ, Скопје
- Јанева, Н., 2010. Извештај за состојбата на Центрите за РДР по спроведените теренски посети. УНИЦЕФ, Скопје
- Јанева, Н., Петроска-Бешка, В. и Еминовска, Е., 2009. Извештај за вклученоста на Ромите во образованието. Институт Отворено Општество, Фонд за образование на Ромите, УНИЦЕФ
- Macleon, H. And Orozova, R., 2007. No wolves along the way: towards a national ECD model for Kyrgyzstan – UNICEF’s pilot interventions in Batken rayon. Bishkek, UNICEF Office in Kyrgyzstan
- Martinez-Vasquez, J., Timofeev, A., and Feruglio, N., 2007. Fiscal decentralization in FYR Macedonia: an assessment. Скопје, UNDP
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të Republikës së Maqedonisë, 2008. Pasqyrë e sistemit të mbrojtjes sociale të Republikës së Maqedonisë, Shkup, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
- Myers, R., 2004. In search of quality of programs in early childhood care and education. Background paper for Education for All Global Monitoring Report, Paris, UNESCO
- Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 114/09
- Orivel, F., Ana, F., Tuhari, I., 2007. Republic of Moldova. Financial and Legal Analysis of Community-based Child and Family Centers. UNICEF Moldova, Chisinau
- Pereznioto, P., and Uzunov, V., 2008. Child-focused public Expenditure Review. Скопје, UNICEF Country Office
- Regalado, M., 2001. Primary Care Services Promoting Optimal Child Development From Birth to Age 3 Years: A review of the literature. American Medical Association, Chicago <http://archpedi.ama-assn.org/cgi/reprint/155/12/1311.pdf>

- Republika e Maqedonisë, 2004. Strategjia nacionale për zhvillimin e hershëm të arsimit 2005-2015. Shkup, Republika e Maqedonisë
- Reynolds, A. And Temple, J., 2008. Cost-effective Early Childhood Development Programs from Preschool to Third Grade. In: the Annual Review of Clinical Psychology. 2008. 4. 109-39. Berkeley, University of California
- Sammons, P., Silva, K., Melhuish, E., Siraj-Blatchford, I., Taggart, B., Barreau, S. And Grabbe, Y. 2007. Influences on children's attainment and progress in key stage 2: social/behavioural outcomes in year 6. London, University of London
- Enti Shtetëror i Statistikës të Republikës së Maqedonisë/УНИЦЕФ, 2007.
- Hulumtim multiindikator për klasterë 2005-2006. Enti Shtetëror i Statistikës të Republikës së Maqedonisë, Shkup
- Enti Shtetëror i Statistikës të Republikës së Maqedonisë, 2009. Maqedonia në numra, 2009. Enti Shtetëror i Statistikës të Republikës së Maqedonisë, Shkup
- Enti Shtetëror i Statistikës të Republikës së Maqedonisë, 2010a. Rajonet e Republikës së Maqedonisë 2009. Enti Shtetëror i Statistikës të Republikës së Maqedonisë, Shkup
- Enti Shtetëror i Statistikës të Republikës së Maqedonisë, 2010b. Vlerësimi i popullatës sipas gjinisë dhe moshës, për komuna dhe rajone statistikore, 2009. Enti Shtetëror i Statistikës të Republikës së Maqedonisë, Shkup
- TransMONEE database: a database operated by the UNICEF Innocenti Research institute. Види: <http://www.unicef-irc.org/databases/transmonee/>
- UNESCO, 2006. Education for All Global Monitoring Report. Strong Foundations: Early Childhood Care and Education, Paris, UNESCO
- UNESCO, 2007. Education for All Global Monitoring Report. Will we make it? Paris, UNESCO
- UNESCO, 2008. Education for All Global Monitoring Report. Overcoming inequality: why governance matters. Paris, UNESCO
- UNICEF Innocenti Research Center, 2009. Innocenti Social Monitor 2009. Florence, Innocenti Research Center
- UNICEF, 2007. Learning Achievement in the CEE/CIS region. A comparative analysis of the results from the 2006 PISA. Geneva, UNICEF
- UNICEF Regional Office for CEE/CIS, 2007. Developmental Readiness for Schooling: Early Childhood Development in CEE/CIS. Geneva, UNICEF Regional Office for CEE/CIS

- Van Ravens, J., 2008a. Scenarios for ECD in Armenia: financial and legal analysis of national preschool education programs, policies and strategies in the republic of Armenia. UNICEF Office, Jerevan
- Van Ravens, J., 2008b. Expanding ECCE in Bangladesh: it can be done. An assessment of the financial feasibility of achieving Education for All goal one. UNESCO Office, Dhaka
- Van Ravens, J., 2009. ECD in Nepal: expansion, inclusion, quality. A study to support the further development of Nepal's national policy for ECD. UNICEF Office, Kathmandu
- Van Ravens, J., 2010a. Holistic ECD for all in Indonesia: supporting communities to close the gap. UNICEF Office, Jakarta
- Van Ravens, J., 2010b. Financing ECD in Tanzania: Cost and Financing Scenarios to Support the Implementation of the Integrated ECD Policy of Tanzania. UNICEF Office, Dar es Salaam
- Van Ravens, J., 2010c. A better future for every child. Financially feasible scenarios for the equitable expansion of preschool education in Kyrgyzstan. World Bank, UNICEF and Aga Khan Foundation, Bishkek
- Van Ravens, J. and Aggio, C., 2008. Expanding early childhood care and education: How much does it cost? Working Paper 46. The Hague, Bernard van Leer Foundation
- Verme, P., 2008. A Proposal for a Reform of the Social Assistance System and for the introduction of Conditional Cash Transfers in the Republic of Macedonia. Skopje, Ministry of Labour and Social Policy
- Walker, S., Wachs, T., Gardner, J., Lozoff, B., Wasserman, G., Pollitt, E., and Carter, J. 2007. Child development: risk factors for adverse outcomes in developing countries. In: The Lancet, 369(9556) 13 January, fq. 145-157
- Zafeirakou, A., 2006. Providing access to education and care for all children 0 to 7. Early childhood care and education in South East Europe: progress, challenges new orientations. Background paper for the EFA Global Monitoring Report. Paris, UNESCO

